



# FLETORJA ZYRTARE

E

## REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 56

2001

Dhjetor

### P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.8831, datë 22.11.2001	Për pronësinë shtetërore në shoqëritë tregtare financiare me kapital tërësisht shtetëror.....	1761
Ligj nr.8832, datë 22.11.2001	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për parandalimin dhe dënimin e krimeve kundër personave të mbrojtur, në nivel ndërkombëtar, duke përfshirë agjentët diplomatikë”.....	1762
Ligj nr. 8833, datë 22.11.2001	Për ratifikimin e “Marrëveshjes për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të OPEC-ut për Zhvillim Ndërkombëtar”.....	1768
Ligj nr. 8834, datë 22.11.2001	Për ratifikimin e “Konventës për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Europë” (Lisbonë, 1997).....	1773
Ligj nr.8835, datë 22.11.2001	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Protokollin për shtypjen e veprimeve të paligjshme në aeroportet, që i shërbejnë aviacionit civil ndërkombëtar”, shtesë e “Konventës për shtypjen e veprimeve të paligjshme kundër sigurisë së aviacionit civil”.....	1785
Vendim i Kuvendit nr.13, datë 22.11. 2001	Për disa plotësime në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit.....	1796

**L I G J**  
**Nr.8831, datë 22.11.2001**

**PËR PRONËSINË SHTETËRORE NË SHOQËRITË TREGTARE FINANCIARE ME  
KAPITAL TËRËSISHT SHTETËROR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

Neni 1

Ministria e Financave, e përfaqësuar nga Ministri, vepron në emër të shtetit dhe është pronare e bankave tregtare dhe e shoqërive shtetërore të sigurimit të dëmeve dhe të jetës, të cilat janë me kapital tërësisht shtetëror.

Neni 2

Neni 1 i dekretit nr.1430, datë 27.3.1996 “Për një shtesë në ligjin nr.8033, datë 16.11.1995 “Për transformimin e bankave tregtare shtetërore në shoqëri tregtare dhe lejimin e privatizimit të tyre”, si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore, që bie në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, shfuqizohen.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3166, datë 10.12.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Rexhep Meidani**

**L I G J**  
**Nr.8832, datë 22.11.2001**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “KONVENTËN PËR  
PARANDALIMIN DHE DËNIMIN E KRIMEVE KUNDËR PERSONAVE TË MBROJTUR,  
NË NIVEL NDËRKOMBËTAR, DUKE PËRFSHIRË AGJENTËT DIPLOMATIKË”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Konventën për parandalimin dhe dënimin e krimeve

kundër personave të mbrojtur, në nivel ndërkombëtar, duke përfshirë agjentët diplomatikë” të 14 dhjetorit 1973.

## Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3167, datë 10.12.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

### KONVENTA

**MBI PARANDALIMIN DHE DËNIMIN E KRIMEVE KUNDËR PERSONAVE TË MBROJTUR, NË NIVELIN NDËRKOMBËTAR, DUKE PËRFSHIRË DHE AGJENTËT DIPLOMATIKË**

Asambleja e Përgjithshme,

Duke pasur parasysh se kodifikimi dhe zhvillimi progresiv i së drejtës ndërkombëtare ndihmon në zbatimin e qëllimeve dhe parimeve të përcaktuara në nenet 1 dhe 2 të Kartës së Kombeve të Bashkuara,

Duke kujtuar se në përgjigje të kërkesës së bërë në rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 2780 (XXVI) të datës 3 dhjetor 1971, Komisioni i të Drejtës Ndërkombëtare, në sesionin e tij të njëzet e katërt, studioi çështjen e mbrojtjes dhe paprekshmërisë të agjentëve diplomatikë dhe personave të tjerë që gëzojnë mbrojtje të veçantë sipas së drejtës ndërkombëtare dhe hartoi projektnehet për parandalimin dhe dënimin e krimeve kundër personave të tillë,

Pasi mori në konsideratë projektnehet dhe gjithashtu edhe komentet e vërejtjet e paraqitura nga shtetet, agjencitë e specializuara dhe organizata të tjera ndërqeveritare, në përgjigje të ftesës së bërë nga Asambleja e Përgjithshme në rezolutën e saj 2926 (XXVII) të datës 28 nëntor 1972,

Të bindur për rëndësinë e përfundimit të një marrëveshjeje ndërkombëtare mbi masat e duhura dhe efektive për parandalimin dhe dënimin e krimeve kundër agjentëve diplomatikë dhe personave të tjerë të mbrojtur në nivel ndërkombëtar, duke pasur parasysh kërcënimin serioz, të krijuar nga kryerja e krimeve të tilla, në drejtim të mbajtjes dhe nxitjes së marrëdhënieve miqësore dhe bashkëpunimin midis shteteve,

Kanë zhvilluar për këtë qëllim dispozitat që përmbahen në Konvetën e bashkëngjitur këtu.

1. Miraton Konventën mbi parandalimin dhe dënimin e Krimeve kundër personave të mbrojtur në nivel ndërkombëtar, duke përfshirë Agjentët Diplomatikë, bashkëngjitur në rezolutën e tanishme.

2. Rithekson rëndësinë e madhe të rregullave të së drejtës ndërkombëtare lidhur me paprekshmërinë dhe mbrojtjen që duhet t'i sigurohet personave të mbrojtur në nivelin ndërkombëtar dhe detyrimet e shteteve në lidhje me to.

3. Konsideron se Konventa e bashkëngjitur do të mundësojë shtetet të realizojnë detyrimet e tyre në mënyrë më efikase.

4. Njeh gjithashtu se dispozitat e Konventës bashkëngjitur nuk mund, në ndonjë mënyrë, të paragjykojnë ushtrimin e së drejtës legjitime të vetvendosjes dhe pavarësisë, në përputhje me qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe Deklaratën mbi Parimet e së Drejtës Ndërkombëtare në lidhje me marrëdhëniet miqësore dhe bashkëpunimin midis shteteve, në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, nga popujt që luftojnë kundër kolonializimit, sundimit të huaj, pushtimit të huaj, diskriminimit racial dhe aparteidit.

5. Fton shtetet të bëhen Palë në Konventën e bashkëngjitur.

6. Vendos se rezoluta e tanishme, dispozitat e të cilës janë të lidhura me Konventën e bashkëngjitur, duhet gjithmonë të publikohet së bashku me të.

Mbledhja plenare e 2202-të

14 dhjetor 1973

## ANEKS

### **KONVENTA MBI PARANDALIMIN DHE DËNIMIN E KRIMEVE KUNDËR PERSONAVE TË MBROJTUR, NË NIVELIN NDËRKOMBËTAR, DUKE PËRFSHIRË DHE AGJENTËT DIPLOMTIKË**

Shtetet Palë në këtë Konventë,

Duke pasur në mendje qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara lidhur me ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare dhe nxitjen e marrëdhënieve miqësore dhe bashkëpunimin midis shteteve,

Duke konsideruar se krimet kundër agjentëve diplomatikë dhe personave të tjerë të mbrojtur në nivelin ndërkombëtar, që rrezikojnë sigurinë e këtyre personave, krijojnë një kërcënim serioz për mbajtjen e marrëdhënieve ndërkombëtare normale, të cilat janë të nevojshme për bashkëpunimin midis shteteve,

Duke besuar se kryerja e krimeve të tilla është një çështje me shqetësim të madh për komunitetin ndërkombëtar,

Të bindur se ekziston një nevojë urgjente për të miratuar masat e përshtatshme dhe efektive për parandalimin dhe dënimin e krimeve të tilla,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

#### Neni 1

Për qëllimet e kësaj Konvente:

1. “Person i mbrojtur në nivel ndërkombëtar” nënkupton:

(a) Kryetari i Shtetit, duke përfshirë çdo anëtar të një organi kolegjial që kryen funksionet e një Kryetari Shteti sipas Kushtetutës së Shtetit në fjalë, Kryetari i Qeverisë ose Ministri i Punëve të Jashtme, kurdoherë që ndonjëri prej personave të tillë është në një shtet të huaj, si dhe anëtarët e familjes së tij që e shoqërojnë atë;

(b) çdo përfaqësues ose zyrtar i një shteti ose çdo zyrtar ose agjent i një organizate ndërkombëtare me karakter ndërqeveritar, i cili në kohën dhe në vendin ku një krim kundër tij, ndërtesës së tij zyrtare, banesës së tij private ose mjeteve të tij të transportit, është kryer, gëzon në bazë të së drejtës ndërkombëtare mbrojtje të veçantë nga ndonjë sulm kundër personit të tij, lirisë ose dinjitetit të tij, ashtu si edhe anëtarët e familjes së tij që bëjnë pjesë në familjen e tij;

2. “I pandehuri” nënkupton një person për të cilin ka të dhëna të mjaftueshme për të përcaktuar prima facie se ai ka kryer ose ka marrë pjesë në një ose më shumë krime, të përcaktuara në nenin 2.

#### Neni 2

1. Kryerja me paramendim e:

(a) vrasjes, rrëmbimit ose sulmeve të tjera ndaj personit ose lirisë së një personi të mbrojtur në nivel ndërkombëtar;

(b) sulmit të dhunshëm ndaj ambienteve zyrtare, banesës private ose mjeteve të transportit të një personi të mbrojtur në nivelin ndërkombëtar, të tilla që vënë në rrezik jetën e personit ose lirinë e tij;

(c) kërcënimit për të kryer ndonjë sulm të tillë;

(d) përpjekjes për të kryer një sulm të tillë; dhe

(e) veprimit që përbën pjesëmarrje si autor në ndonjë sulm të tillë, do të cilësohen nga çdo Shtet Palë krime sipas të drejtës së tij kombëtare.

2. Çdo Shtet Palë do t'i bëjë këto krime të dënueshme me dënime të përshtatshme, të cilat do të marrin parasysh natyrën e tyre të rëndë.

3. Paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni në asnjë mënyrë nuk prekin detyrimet e Shteteve Palë sipas të Drejtës Ndërkombëtare për të marrë të gjitha masat e duhura për të parandaluar sulme të tjera mbi personin, lirinë ose dinjitetin e një personi të mbrojtur në nivelin ndërkombëtar.

### Neni 3

1. Çdo Shtet Palë duhet të marrë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi krimet e përcaktuara në nenin 2 në rastet e mëposhtme:

(a) kur krimi kryhet në territorin e atij shteti ose në bordin e një anijeje ose avioni të regjistruar në atë shtet;

(b) kur i pandehuri është shtetas i atij shteti;

(c) kur krimi kryhet kundër një personi të mbrojtur në nivelin ndërkombëtar siç përcaktohet në nenin 1, i cili gëzon statusin e tij si të tillë në sajë të funksioneve që ai ushtron në emër të atij shteti.

2. Çdo Shtet Palë duhet, gjithashtu, të marrë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi këto krime, në rastet ku i pandehuri ndodhet në territorin e tij dhe ai nuk e ekstradon atë, në përputhje me nenin 8, në ndonjë nga shtetet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Kjo Konventë nuk përjashton ndonjë juridiksion penal të ushtruar në përputhje me të drejtën kombëtare.

### Neni 4

Shtetet Palë do të bashkëpunojnë në parandalimin e krimeve të përcaktuara në nenin 2, veçanërisht nëpërmjet:

(a) duke marrë të gjitha masat e zbatueshme për të parandaluar përgatitjet në territoret e tyre respektive për kryerjen e këtyre krimeve brenda ose jashtë territorit të tyre;

(b) duke shkëmbyer informacionin dhe duke koordinuar marrjen e masave administrative dhe masave të tjera të përshtatshme për të parandaluar kryerjen e këtyre krimeve.

### Neni 5

1. Shteti Palë në të cilin është kryer ndonjë nga krimet e përcaktuara në nenin 2 duhet, në qoftë se ai ka arsye të besojë se i pandehuri është larguar nga territori i tij, t'i komunikojë të gjitha shteteve të tjerë të interesuar, direkt ose nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, të gjitha faktet e drejtpërdrejta lidhur me krimin e kryer dhe të gjithë informacionin në dispozicion lidhur me identitetin e të pandehurit.

2. Kurdoherë që ndonjë nga krimet e përcaktuara në nenin 2 është kryer kundër një personi të mbrojtur në nivelin ndërkombëtar, çdo Shtet Palë që ka informacion në lidhje me viktimën dhe rrethanat e krimit duhet të përpiqet t'ia transmetojë atë, sipas kushteve të përcaktuara në të drejtën e tij të brendshme, të plotë dhe menjëherë Shtetit Palë në emër të të cilit viktimë ushtronte funksionet e tij.

### Neni 6

1. Pasi binden se rrethanat e përligjin një gjë të tillë, Shteti Palë, në territorin e të cilit i pandehuri është i pranishëm, duhet të marrë masat e përshtatshme sipas së drejtës së tij të brendshme në mënyrë që të sigurohet prania e tij për qëllimin e procedimit ose ekstradimit. Masa të tilla duhet t'u njoftohen pa vonesë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara:

(a) Shtetit ku është kryer krimi;

(b) Shtetit ose Shteteve, shtetas i të cilit është i pandehur ose në qoftë se ai është person pa shtetësi, shtetit, në territorin e të cilit ai banon në mënyrë të përhershme;

(c) Shtetit ose Shteteve, shtetas i të cilit është personi i mbrojtur në nivelin ndërkombëtar, ose shtetit në emër të të cilit ai ushtronte funksionet e tij;

(d) të gjitha shteteve të tjera të interesuara; dhe

(e) organizatës ndërkombëtare, zyrtar ose përfaqësues i të cilës është personi i mbrojtur në nivelin ndërkombëtar.

2. Çdo person, ndaj të cilit po merren masat e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, ka të drejtë:

(a) të komunikojë pa vonesë me përfaqësuesin e përshtatshëm më të afërt të Shtetit, shtetas i të cilit ai është ose të shtetit, i cili është i detyruar të mbrojë të drejtat e tij në mënyrë tjetër ose, në qoftë se ai është një person pa shtetësi, shtetit të cilit ai i kërkon dhe që është i gatshëm të mbrojë të drejtat e tij; dhe

(b) të vizitohet nga një përfaqësues i atij Shteti.

#### Neni 7

Shteti Palë në territorin e të cilit i pandehuri është i pranishëm, në qoftë se ai nuk e ekstradon atë, do të paraqesë rastin pa asnjë lloj përjashtimi dhe pa vonesa të pajustificuara, autoriteteve të tij kompetente me qëllim hetimi, sipas procedurave, në përputhje me ligjet e atij shteti.

#### Neni 8

1. Deri në masën që krimet e parashikuara në nenin 2 nuk janë përcaktuar si shkelje të ekstradueshme në ndonjë traktat ekstradimi që ekziston midis Shteteve Palë, ato do të konsiderohen për t'u përfshirë si të tilla në të. Shtetet Palë marrin përsipër t'i përfshijnë këto krime si shkelje të ekstradueshme në çdo traktat të ardhshëm ekstradimi, që do të lidhet ndërmjet tyre.

2. Në qoftë se një Shtet Palë, që e kushtëzon ekstradimin me ekzistencën e një marrëveshjeje, merr një kërkesë për ekstradim nga një Shtet tjetër Palë me të cilin ai nuk ka marrëveshje ekstradimi, në qoftë se ai vendos ta bëjë ekstradimin, mund ta konsiderojë këtë Konventë si bazë ligjore për ekstradim në lidhje me këto krime.

Ekstradimi do t'i nënshtrohet dispozitave procedurale dhe kushteve të tjera ligjore të së drejtës së shtetit që i kërkohet.

3. Shtetet Palë, të cilët nuk e kushtëzojnë ekstradimin me ekzistencën e ndonjë marrëveshjeje, do t'i njohin këto krime si shkelje të ekstradueshme ndërmjet njëri-tjetrit, duke iu nënshtruar dispozitave procedurale dhe kushteve të tjera të së drejtës së shtetit që i kërkohet.

4. Secili nga krimet do të trajtohet, për qëllimin e ekstradimit ndërmjet Shteteve Palë, sikur të jetë kryer jo vetëm në vendin në të cilin ai ndodhi, por gjithashtu në territoret e shteteve, që u kërkohet të vendosin juridiksionin e tyre në përputhje me paragrafin 1 të nenit 3.

#### Neni 9

Çdo personi, në lidhje me të cilin po kryhen procedimet mbi ndonjë nga krimet e përcaktuara në nenin 2, duhet t'i garantohet një trajtim i drejtë në të gjitha fazat e procedimit.

#### Neni 10

1. Shtetet Palë duhet t'i japin njëri-tjetrit masën më të madhe të ndihmës në lidhje me procedimet penale të filluara lidhur me krimet e përcaktuara në nenin 2, duke përfshirë dhënien e të gjitha provave në dispozicion të tyre të nevojshme për procedimin.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni nuk do të ndikojnë mbi detyrimet lidhur me ndihmën gjyqësore të përbashkët të shprehur në ndonjë marrëveshje tjetër.

#### Neni 11

Shtetet Palë, ku i pandehuri ndiqet penalisht, duhet t'ia komunikojnë rezultatin përfundimtar të gjykimit Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili duhet t'ua transmetojë këtë informacion Shteteve të tjera Palë.

## Neni 12

Dispozitat e kësaj Konvente nuk do të ndikojnë në zbatimin e marrëveshjeve mbi azilin, në fuqi në ditën e miratimit të kësaj Konvente, ndërmjet shteteve që janë palë e këtyre marrëveshjeve; por një Shtet Palë në këtë Konventë nuk mund t'u referohet këtyre marrëveshjeve në lidhje me çdo Shtet tjetër Palë në këtë Konventë, i cili nuk është Palë në këto marrëveshje.

## Neni 13

1. Çdo mosmarrëveshje midis dy ose më shumë Shteteve Palë, lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, që nuk mund të zgjidhet me anë të bisedimeve do t'i paraqitet arbitrazhit, me kërkesën e njëres prej tyre. Nëse brenda gjashtë muajve nga data e kërkesës për arbitrim, Palët nuk do të bien dakord mbi organizimin e arbitrimit, çdonjëra nga këto Palë mund t'ia referojë mosmarrëveshjen Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, me anë të një kërkesë në përputhje me Statusin e Gjykatës.

2. Çdo Shtet Palë mund, që në kohën e nënshkrimit ose ratifikimit të kësaj Konvente ose aderimit në të, të deklarojë se ai nuk e konsideron veten të detyruar nga paragrafi 1 i këtij neni. Shtetet e tjera Palë nuk do të jenë të detyruar nga paragrafi 1 i këtij neni, në lidhje me çdo Shtet Palë që ka bërë një rezervim të tillë.

3. Çdo Shtet Palë që ka bërë një rezervim në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, mundet në çfarëdo kohe, të tërheqë këtë rezervë me anë të njoftimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

## Neni 14

Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga të gjitha shtetet deri në 31 Dhjetor 1974 në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork.

## Neni 15

Kjo Konventë do t'i nënshtrohet ratifikimit. Instrumentet e verifikimit duhet të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

## Neni 16

Kjo Konventë do të mbetet e hapur për aderim nga çdo shtet. Instrumentet e aderimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

## Neni 17

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të njëzet e dytë të ratifikimit ose aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Për çdo shtet që ratifikon ose miraton Konventën pas depozitimit të instrumentit të njëzet e dytë të ratifikimit ose aderimit, Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit nga ky shtet të instrumenteve të tij të ratifikimit ose aderimit.

## Neni 18

1. Çdo Shtet Palë mund ta denoncojë Konventën me anë të njoftimit me shkrim të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas datës në të cilën është marrë njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

## Neni 19

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do të informojë të gjitha Shtetet, midis të tjerave:

- (a) për nënshkrimet e kësaj Konvente për depozitimet e instrumenteve të ratifikimit ose aderimit në përputhje me nenet 14, 15 dhe 16 dhe për njoftimet e bëra sipas nenit 18;
- (b) për datën në të cilën kjo Konventë do të hyjë në fuqi sipas nenit 17.

## Neni 20

Origjinali i kësaj Konvente, mbi të cilën tekstet në gjuhët kineze, anglisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht janë njëlloj autentike do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili do të dërgojë kopje të certifikuara të të gjitha shteteve.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit të autorizuar në mënyrën e duhur nga Qeveritë e tyre përkatëse e kanë nënshkruar këtë Konventë, të hapur për nënshkrim në Nju Jork më 14 dhjetor 1973.

## L I G J

**Nr.8833, datë 22.11.2001**

### **PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN E INVESTIMEVE NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT TË OPEC-UT PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

## **K U V E N D I**

### **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:**

#### Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të OPEC-ut për Zhvillim Ndërkombëtar”.

#### Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3168, datë 10.12.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**



**MARRËVESHJE**  
**PËR NXITJEN DHE MBROJTJEN E INVESTIMEVE MIDIS REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**DHE FONDIT TË OPEC-UT PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR**

Marrëveshje midis Republikës së Shqipërisë (Vendi Pritës) dhe Fondit të OPEC-ut për Zhvillim Ndërkombëtar (Fondi)

Ndërkohë që vendet anëtare të OPEC-ut, duke qenë të vetëdijshëm për nevojën e solidaritetit midis vendeve në zhvillim dhe duke qenë të ndërgjegjshëm për rëndësinë e bashkëpunimit ekonomik midis tyre dhe vendeve të tjera në zhvillim, kanë krijuar Fondin e OPEC-ut për të siguruar mbështetje ekonomike për këto të fundit, përveç kanaleve bilaterale dhe multilaterale nëpërmjet të cilave vendet anëtare të OPEC-ut i japin ndihmë financiare vendeve në zhvillim;

dhe ndërkohë që vendet anëtare të OPEC-ut i kanë dhënë të drejtën Fondit për të marrë pjesë në stimulimin e lëvizjes së kapitalit dhe, veçanërisht, të ndihmojë në financimin e veprimtarive në sektorin privat, që përfshijnë njësi të vendosura në territorin e vendeve të tjera në zhvillim, duke përfshirë Vendlin Pritës, me qëllimin e optimizimit të objektivit të sipërpërmendur të bashkëpunimit financiar;

dhe ndërkohë që Vendi Pritës dhe Fondi kanë rënë dakord që një kuadër stabil për investimet do të maksimizonte përdorimin ekonomik të burimeve dhe do të përmirësonte standardet e jetës; dhe si pasojë kanë rënë dakord të përfundojnë një marrëveshje në lidhje me nxitjen dhe mbrojtjen e këtyre veprimtarive të investimit;

Për këto arsye, Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1  
**Përkufizime**

1.01 Kudo që përdoret në këtë Marrëveshje, dhe përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

(a) "Investim" nënkupton çdo lloj investimi në pronë ose të kontrolluar direkt ose indirekt nga Fondi në territorin e Vendlit Pritës dhe pa përjashtuar përgjithësinë e sa më sipër, përfshin investime që përbëhen nga:

(i) aksione dhe ndonjë formë tjetër pjesëmarrjeje në kapital, dhe obligacione, kredi, borxhe dhe forma të tjera të interesave të borxhit në një shoqëri;

(ii) pronësi e prekshme, përfshirë prona të paluajtshme, dhe pronësi të paprekshme, duke përfshirë të drejta si qiraja, pengu, hipoteka etj;

(iii) të drejta kontraktuale, si kontrata ndërtimi dhe menaxhimi, kontrata prodhimi ose ndarjeje të ardhurash, koncensione, ose kontrata të tjera të ngjashme;

(iv) të drejta të dhëna nga ligji, si licenca dhe leje; dhe

(v) pronësi intelektuale, duke përfshirë të drejtat e autorit, patentat, projektet industriale dhe shërbime këshillimore dhe informacion konfidencial biznesi.

(b) "Shoqëria" nënkupton një njësi të krijuar sipas ligjeve të Vendi i Pritës, pjesërisht ose plotësisht në pronësi ose të kontrolluar nga shteti ose ndonjë organ i tij, duke përfshirë bashkëpunimin, partneritetin, joint-venture ose me ortak të vetëm, shoqërimin ose ndonjë organizatë tjetër.

(c) "Fondi" nënkupton Fondin e OPEC-ut për Zhvillim Ndërkombëtar të krijuar nga vendet anëtare të Organizatës së Vendeve Eksportuese të Naftës nëpërmjet Marrëveshjes së Parisit të 28 janarit 1976, me ndryshimet përkatëse.

(d) "Drejtuesit e Fondit" - nënkupton Drejtorin e Përgjithshëm të Fondit ose përfaqësuesin e tij të autorizuar.

(e) "Vendi Pritës" nënkupton Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë ndarjet e saj politike e administrative.

## Neni 2 **Parime të përgjithshme**

2.01 Në lidhje me krijimin, blerjen, zgjerimin, menaxhimin, drejtimin, operimin dhe shitjen e investimeve, Vendi Pritës do t'i japë Fondit trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai i akordon në situata të ngjashme investimeve në territorin e saj të shtetasve të vet ose investimeve në territorin e tij shtetasve ose shoqërive të një Pale të tretë (trajtimi i Palës më të favorizuar), i cili të jetë më i favorshëm (trajtimi kombëtar dhe i Palës më të favorizuar).

2.02 Vendi Pritës do të sigurojë që ligjet e tij, praktikat administrative dhe procedurat e aplikueshme në përgjithësi, si dhe vendimet që kanë të bëjnë ose prekin investimet publikohen menjëherë ose bëhen publike menjëherë.

2.03 Vendi Pritës do të sigurojë mjete efektive për të siguruar pretendimet dhe zbatuar të drejtat në lidhje me investimet dhe nuk do të prekin me masa të paarsyeshme ose diskriminuese menaxhimin, drejtimin, operimin, shitjen ose dispozitë tjetër të ndonjë investimi të tillë.

2.04 Vendi Pritës do t'i akordojë investimeve trajtim të drejtë e të barabartë në të gjithë kohën dhe mbështetje e siguri, dhe nuk do t'i akordojë në asnjë rast trajtim më pak të favorshëm sesa kërkohet nga e drejta ndërkombëtare.

2.05 Vendi Pritës, sipas legjislacionit të tij dhe rregullave të Fondit, në lidhje me çështje që nuk kanë të bëjnë me investitorë kombëtarë ose siç mund të kërkojë rasti, zyrtarët, agjentët dhe përfaqësuesit e tjerë të Fondit, do t'i akordojë trajtim jo më pak të favorshëm nga ai që Vendi Pritës i akordon Palëve të treta, duke përfshirë institucione të tjera multilaterale financiare zhvillimi stafit të tyre, agjentëve dhe përfaqësuesve të tjerë dhe ky trajtim do të shtrihet, por nuk do të kufizohet në lëshimin e vizave ose lejeve për të hyrë dhe qëndruar në territorin e tij për qëllime të fitimit, vlerësimit, krijimit ose administrimit, heqjes ose mbarimit me ndonjë mënyrë tjetër të investimit të tij të vendosur në ndonjë nga territoret e tij ose ndonjë aktivitet i lidhur me të.

## Neni 3 **Lajmërimi paraprak i propozimit të investimit dhe konkurrenca**

3.01 Fondi, para çdo investimi, do të informojë Qeverinë e Vendi Pritës në lidhje me investimin e propozuar në formën e një propozimi projekti. Ky propozim i shkruar do të mbajë një pasqyrë përmbledhëse në lidhje me investimin e parashikuar dhe do t'i jepet Ministrit të Financave ose ndonjë përfaqësuesi tjetër të Vendi Pritës nga Fondi për shqyrtim.

3.02 Fondi nuk do të financojë ndonjë investim në territorin e Vendi Pritës, në qoftë se Qeveria e Vendi Pritës kundërshton këtë financim.

## Neni 4 **Shpronësimi ose nacionalizimi**

4.01 Vendi Pritës nuk do të shpronësojë ose nacionalizojë një investim, direkt ose indirekt, nëpërmjet masave të shpronësimit ose nacionalizimit, përveç për qëllim publik; në mënyrë jodiskriminuese; me pagesë të menjëhershme të përshtatshme dhe efektive dhe në përputhje me procesin ligjor dhe parimet e përgjithshme të trajtimit, të dhëna në nenin 2 më sipër.

4.02 Kompensimi do të paguhet pa vonesë dhe do të jetë ekuivalent i vlerës së tregut të investimit të shpronësuar menjëherë përpara se të ndërmerrej veprimi i shpronësimit; dhe të jetë i realizueshëm dhe lirisht i transferueshëm. Vlera e tregut nuk do të reflektojë ndonjë ndryshim në vlerë që rezulton sepse veprimi shpronësues ka qenë bërë i ditur para datës së shpronësimit.

## Neni 5 **Trajtimi më i favorizuar**

5.01 Vendi Pritës do t'i akordojë trajtimin e Palës kombëtare dhe më të favorizuar investimeve në lidhje me ndonjë masë në lidhje me humbjet që pësojnë investimet në territorin e tij

që rrjedhin nga lufta ose konflikt i armatosur, gjendje emergjence kombëtare, luftë civile ose ngjarje të tilla të ngjashme.

5.02 Vendi Pritës do të akordojë kthimin ose pagesën e kompensimit, në përputhje me seksionin 4.02 më sipër të ngjarjeve që investimet pësojnë në territorin e tij, që i detyrohen luftës ose konfliktit të armatosur, revolucionit, emergjencës kombëtare, luftës civile e ngjarje të ngjashme që rezultojnë në:

- (a) marrjen e një pjese ose gjithë investimit nga autoritetet e Vendi Pritës; ose
- (b) shkatërrimin e një pjese ose tërë investimit nga autoritetet e Vendi Pritës që nuk është kërkuar nga nevoja e situatës.

## Neni 6

### **Pagesat dhe transferimi**

60.1 Vendi Pritës do të lejojë që të gjitha transferimet në lidhje me një investim të bëhen pa zbritje për ose pa taksa, komisione ose kufizime të tjera, si dhe pa vonesë në dhe nga territori i tij.

Këto transfertat përfshijnë:

- (a) kontribute të kapitalit;
- (b) fitime, të ardhurat e kapitalit dhe shumat nga shitja e të gjithë ose një pjese të investimit ose nga likuidimi total ose i pjesshëm i investimit;
- (c) interesi, pagesa për mbretërinë, komisione menaxhimi, asistencë teknike dhe komisione të tjera;
- (d) pagesa të bëra sipas kontratës; dhe
- (e) kompensim sipas nenit 4 dhe 5.

60.2 Vendi Pritës do të lejojë që transfertat të bëhen në monedhë lirisht të përdorshme në kursin e tregut në datën e transferimit.

6.03 Përveç seksioneve 6.01 dhe 6.02, Vendi Pritës mund të ndalojë transferimin në zbatim të ligjeve të tij në mirëbesim, në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese në lidhje me:

- (a) falimentimin, insolvencën ose mbrojtjen e të drejtave të kreditorëve;
- (b) lëshimin, tregtimin ose çështje të sigurisë;
- (c) shkelje kriminale ose penale;
- (d) sigurimin e përputhshmërisë me rregullat dhe gjykimet në procedura gjykimi.

## Neni 7

### **Konsultimi**

7.01 Palët e kësaj marrëveshjeje bien dakord të konsultohen, me kërkesën e secilit për të zgjidhur ndonjë konflikt, kundërshtim ose pretendim në lidhje me këtë marrëveshje ose shkeljen, mbarimin ose pavlefshmërinë e saj ose në lidhje me interpretimin ose aplikimin e Marrëveshjes ose realizimin e objektivave të kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 8

### **Klauzola e Arbitrazhit**

8.01 Ndonjë konflikt, mosmarrëveshje ose pretendim që lind nga kjo marrëveshje ose shkelja, mbarimi ose pavlefshmëria e saj që ka të bëjë me interpretimin ose aplikimin e kësaj Marrëveshjeje, që nuk zgjidhet me konsultime, do të dërgohet me kërkesën e secilës Palë në një gjykatë arbitrazhi për vendim të detyrueshëm, në përputhje me rregullat e të drejtës ndërkombëtare. Në mungesë të ndonjë marrëveshjeje midis Palëve për të kundërtën, rregullat e UNCITRAL-it për arbitrazhin në fuqi në datën e marrëveshjes do të përdoren.

8.02 Vendi Pritës dhe Fondi do të emërojnë nga një arbitër dhe këta të dy do të zgjidhin një të tretë si kryetar dhe, nëse nuk bien dakord ai, do të zgjidhet nga Arbitrazhi Ndërkombëtar në Paris, Francë. Aty ku rregullat e UNCITRAL-it nuk japin një situatë të veçantë, arbitrat, me

mendimin e tyre, do të vendosin çfarë veprimi do të vazhdojë dhe vendimi i tyre do të jetë final.

8.03 Arbitrazhi do të bëhet në një shtet (jo Vendi Pritës) që është Palë e UNCTAD (lidhur në Nju Jork, në 10 qershor 1958) dhe gjuha që do të përdoret gjatë gjithë procesit do të jetë anglishtja.

8.04 Çdo Palë e kësaj Marrëveshjeje heq dorë nga ndonjë e drejtë e imunitetit prej sovranitetit në lidhje me pasuritë e saj në lidhje me aplikimin dhe ekzekutimin e ndonjë vendimi të dhënë nga arbitrazhi sipas kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 9 **Ligji rregullues**

9.01 Kjo Marrëveshje dhe gjithë dokumentet e lidhura me të, vlefshmëria, aplikimi dhe interpretimi do të rregullohen nga parimet e të drejtës ndërkombëtare dhe et aequo et bono.

## Neni 10 **Ruajtja e të drejtave dhe detyrimeve të tjera**

10.01 Kjo Marrëveshje nuk do të shmanget nga ndonjë prej të mëposhtmeve, që i japin investimeve trajtimin më të favorshëm sesa i akordohet nga kjo Marrëveshje:

(a) ligjet dhe rregulloret, praktikat administrative ose procedurat, ose vendimet administrative ose gjyqësore të Vendi Pritës;

(b) detyrimet ligjore ndërkombëtare;

(c) ndonjë detyrim tjetër i marrë nga Palët e kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë ato të dhëna në një autorizim investimi ose ndonjë marrëveshje ose ndonjë sipërmarrje tjetër ligjërish të detyrueshme për ose në lidhje me një investim.

## Neni 11 **Hyrja në fuqi, kohëzgjatja dhe mbarimi**

11.01 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi me marrjen e opinioneve ligjore nga Fondi i OPEC-ut, përfshirë një opinion ligjor ose vërtetim tjetër të lëshuar nga Ministri i Drejtësisë së Vendi Pritës, ose departamenti ligjor kompetent, që tregon se kjo Marrëveshje është e autorizuar dhe ratifikuar ose aprovuar në mënyrë tjetër nga Vendi Pritës, në përputhje me kërkesat e saj kushtetuese dhe përbën detyrim të vlefshëm për Vendi Pritës, në përputhje me termat e saj.

11.02 Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë prej 10-vjetësh dhe do të vazhdojë fuqinë, përveç kur përfundohet ndryshe sipas seksionit 11.03.

11.03 Secila Palë mund të mbarojë këtë Marrëveshje në fund të periudhës 10-vjeçare të parë ose në ndonjë kohë tjetër, duke i dhënë lajmërim me shkrim Palës tjetër 1 vit përpara.

11.04 Pavarësisht nga mbarimi i kësaj Marrëveshjeje, të gjitha dispozitat e tjera, përveç atyre të lidhura me krijimin e një investimi të ri do të vazhdojnë të aplikohen në investime të krijuara ose të fituara para datës së mbarimit dhe të mbeten në fuqi për një periudhë 10-vjeçare nga data e thënë.

Në dështim të kësaj, Palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në dy kopje në anglisht, secila e konsideruar si origjinal dhe me të njëjtën fuqi.

**PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Anastas Angjeli

Ministër i Financave

Adresa: Ministria e Financave, Bul. "Dëshmorët e Kombit" Nr. 1

Data e nënshkrimit: 9.3.2001

PËR FONDIN E OPEC-ut PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR  
Dr. Seyyid Abdulai  
Drejtor i Përgjithshëm  
Fondi i OPEC-ut për Zhvillim Ndërkombëtar

Data e nënshkrimit: 20.2.2001

**L I G J**  
**Nr.8834, datë 22.11.2001**

**PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS PËR NJOHJEN E KUALIFIKIMEVE TË ARSIMIT  
TË LARTË NË EUROPË” (LISBONË, 1997)**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

**Neni 1**

Ratifikohet “Konventa për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Europë” (Lisbonë, 1997).

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3169, datë 10.12.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Rexhep Meidani

**KONVENTA**  
**PËR NJOHJEN E KUALIFIKIMEVE TË ARSIMIT TË LARTË NË EUROPË**

Lisbonë 1997

Palët e pranishme në këtë Konventë:

Të ndërgjegjshme për faktin se e drejta për arsimin është e drejtë e njeriut dhe se arsimit i lartë, që luan një rol të rëndësishëm në marrjen dhe përparimin e dijeve, përbën një pasuri të jashtëzakonshme kulturore dhe shkencore, si për individët, ashtu edhe për shoqërinë;

Duke marrë në konsideratë faktin se arsimit i lartë duhet të luajë një rol thelbësor në promovimin e paqes, të mirëkuptimit të ndërsjellë dhe të tolerancës dhe që të kontribuojë në krijimin e besimit të ndërsjellë midis popujve dhe kombeve;

Duke marrë në konsideratë faktin se diversiteti i madh i sistemeve arsimore që ekziston në Europë reflektohet në diversitetet kulturore, sociale, politike, filozofike, fetare dhe ekonomike dhe që nga ky moment përfaqëson një pasuri të jashtëzakonshme që duhet respektuar plotësisht;

Duke dashur t'u lejojnë të gjithë europianëve të përfitojnë plotësisht nga pasuria që përfaqëson ky diversitet, duke lehtësuar pjesëmarrjen e qytetarëve të çdo shteti dhe të studentëve të shkollave të larta të çdo Pale në burimet arsimore të Palëve të tjera dhe, me veçanërisht, duke u lejuar atyre të vazhdojnë formimin ose të kryejnë një pjesë të studimeve në shkollat e larta të këtyre Palëve të tjera;

Duke konsideruar faktin që njohja e studimeve, dëftesave, diplomave dhe e titujve të marrë në një shtet tjetër europian përbën një masë të rëndësishme për nxitjen e mobilitetit akademik ndërmjet Palëve;

Duke i kushtuar një rëndësi të madhe parimeve të autonomisë së shkollave dhe të ndërgjegjshëm për domosdoshmërinë e ruajtjes dhe mbrojtjes së këtij parimi;

Të bindur që një njohje e barabartë e kualifikimeve përfaqëson një element kyç të së drejtës për arsimim dhe një përgjegjësi të shoqërisë;

Duke pasur parasysh Konventat e Këshillit të Evropës dhe të UNESCO-s në lidhje me njohjen akademike në Europë;

Konventa Europiane për ekuivalentimin e diplomave që lejojnë regjistrimin në universitet (1953, STE No 15) dhe Protokollin i saj shtesë (1964, STE No 49);

Konventa Europiane për ekuivalentimin e periudhave të studimeve unviersitare (1956, STE No 21);

Konventa Europiane mbi njohjen akademike të kualifikimeve unviersitare (1959, STE No 32);

Konventa për njohjen e studimeve dhe të diplomave të arsimit të lartë në Shtetet e Europës (1979);

Konventa Europiane për ekuivalentimin e përgjithshëm të periudhës së studimeve unviersitare (1990, STE No 138);

Gjithashtu, duke pasur parasysh Konventën Ndërkombëtare mbi njohjen e studimeve, të diplomave dhe të gradave të arsimit të lartë në Shtetet Arabe dhe në Shtetet Europiane që lag Mesdheu (1967), e adoptuar në kuadër të UNESCO-s dhe që mbulon pjesërisht njohjen akademike në Europë;

Duke kujtuar se kjo Konventë duhet të konsiderohet edhe në kontekstin e Konventave dhe të Rekomandimeve Ndërkombëtare të UNESCO-s që mbulojnë rajone të tjera të botës dhe se është i domosdoshëm përmirësimi i shkëmbimeve të informacioneve ndërmjet këtyre rajoneve;

Të ndërgjegjshëm për evolucionin e thellë në arsimin e lartë në rajonin e Europës që kur janë adoptuar këto Konventa, duke pasur për pasojë një rritje të diversifikimit si në gjirin e sistemeve kombëtare të arsimit të lartë, ashtu edhe ndërmjet tyre, si dhe të nevojës së përshtatjes të instrumenteve juridike dhe praktikave për të reflektuar këtë evolucion;

Të ndërgjegjshëm për domosdoshmërinë e gjetjes së zgjidhjeve të përbashkëta për probleme praktike të shtruara nga njohja në Rajonin Europian;

Të ndërgjegjshëm për domosdoshmërinë e përmirësimit të praktikave të tanishme të njohjes, për t'i bërë më transparente dhe të përshtatura më mirë me gjendjen aktuale të arsimit të lartë në Rajonin Europian;

Të bindur për rëndësinë e një konvente të përpunuar dhe të adaptuar nën patronazhin e përbashkët të Këshillit të Evropës dhe të UNESCO-s, duke krijuar një kuadër për zhvillimin e ardhshëm të praktikave të njohjes në Rajonin Europian;

Të ndërgjegjshëm për rëndësinë e parashikimit të mekanizmave të përhershme të vënies në jetë, me qëllim zbatimin e parimeve dhe dispozitave të kësaj Konvente,

Kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Seksioni I. Përcaktime

## Neni 1

Sipas kësaj Konvente, termat e përmendur më poshtë do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

Pranim (në arsimin e lartë) - është e drejta e kandidatëve për të kërkuar dhe për t'u marrë në konsideratë për t'u pranuar në arsimin e lartë.

Pranim (në institucionet dhe programet e arsimit të lartë) - është akti ose sistemi që u lejon kandidatëve të cilësuar për të ndjekur studimet në një institucion të caktuar dhe/ ose në një program të caktuar të arsimit të lartë.

Vlerësim (i institucioneve dhe i programeve) - është procesi që përcakton cilësinë e mësimdhënies në një institucion ose të një programi të arsimit të lartë.

Vlerësim (i kualifikimeve individuale) - vlerësim me shkrim, nga një organizëm kompetent, i kualifikimeve jashtë shtetit të një individi.

Autoritete kompetente në fushën e vlerësimit - një organizëm i ngarkuar zyrtarisht të japë vendime shtrënguese për njohjen e kualifikimeve të huaja.

Arsim i lartë - të gjitha tipet e cikleve të studimeve ose bashkësia e cikleve të studimit, të formimit ose formimit për kërkim, i nivelit post-sekondar, të njohura nga autoritetet përkatëse të një Pale sipas sistemit të saj të arsimit të lartë.

Institucion i arsimit të lartë - institucion përhapës i arsimit të lartë dhe i njohur nga autoritetet kompetente të një Pale sipas sistemit të saj të arsimit të lartë.

Program i arsimit të lartë - cikël studimesh i njohur nga autoritetet kompetente të një Pale sipas sistemit të arsimit të lartë dhe përfundimi i suksesshëm i të cilave i jep studentit një kualifikim të arsimit të lartë.

Periudhë studimesh - çdo pjesë e një programi të arsimit të lartë, që ka qenë objekt i një vlerësimi ose të një vlefshmërie dhe që, megjithëse nuk përbën një program të plotë studimesh në vetvete, përfaqëson një përvojë domethënëse të njohjeve të aftësive.

#### Kualifikim

A. Kualifikim i arsimit të lartë. Çdo gradë, diplomë, dëftesë tjetër ose titull tjetër i lëshuar nga një autoritet kompetent dhe që vërteton përfundimin me sukses të një programi të arsimit të lartë.

B. Kualifikim që lejon pranimin në arsimin e lartë - çdo diplomë ose dëftesë tjetër e lëshuar nga një autoritet kompetent, që vërteton përfundimin me sukses të një programi arsimor dhe i jep titullarit të saj të drejtën për t'u marrë në konsideratë për t'u pranuar në një institucion të arsimit të lartë (shih përcaktimin e pranimit).

Njohje - vërtetimi i lëshuar nga një autoritet kompetent për vlerën e një kualifikimi arsimor të huaj, me qëllim pranimin në aktivitetet e arsimit dhe/ose të punësimit.

#### Kushtet e nevojshme

A. Kushte të përgjithshme - kushte që duhet të plotësohen, në të gjitha rastet, për të hyrë në arsimin e lartë, për të hyrë në një nivel të përcaktuar në një nivel të përcaktuar të këtij arsimit ose për dhënien e një kualifikimi të arsimit të lartë të një niveli të caktuar.

B. Kushte të veçanta - kushte që duhet të plotësohen, përveç kushteve të përgjithshme, me qëllim pranimin në një program të veçantë të arsimit të lartë ose dhënien e një kualifikimi të veçantë të arsimit të lartë në një disiplinë të veçantë studimi.

## Seksioni II.Kompetenca të autoriteteve

### Neni II.1

1. Kur autoritetet qendrore të një Pale janë kompetente për të vendosur për çështjet e njohjes, kjo Palë lidhet menjëherë me dispozitat e kësaj Konvente dhe merr masat e domosdoshme për zbatimin e këtyre dispozitave në territorin e saj.

Kur janë njësitë përbërëse të Palës që kanë kompetencën për të vendosur për çështjet e njohjes, Pala i jep, njërit prej depozituesve, një raport të shkurtër mbi situatën ose strukturën e saj konstitucionale, në momentin e nënshkrimit ose gjatë depozitimit të instrumenteve të saj të ratifikimit, të pranimit, aprovimit ose aderimit ose në çdo moment tjetër në vazhdim. Në raste të tilla, autoritetet kompetente të njësive përbërëse të Palëve në fjalë marrin masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente në territorin e tyre.

2. Kur janë institucionet e arsimit të lartë ose njësi të tjera që kanë kompetencë për të vendosur individualisht për çështjet e njohjes, çdo Palë, sipas situatës ose strukturës së saj

konstitucionale, u komunikon tekstin e kësaj Konvente këtyre institucioneve ose njërive dhe merr çdo masë të mundur për t'i inkurajuar ta analizojnë dhe të zbatojnë dispozitat me dashamirësi.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen mutatis mutandis me detyrimet e Palëve sipas neneve të mëtejshëm të kësaj Konvente.

#### Neni II.2

Në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit ose në çdo moment tjetër në vazhdim, çdo Shtet, Selia e Shenjtë, Komuniteti European do t'i tregojnë njërit prej depozituesve të kësaj Konvente cilat janë autoritetet kompetente që marrin vendime të ndryshme në çështje njohjesh.

#### Neni II.3

Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk mund të konsiderohet në kundërshtim me dispozitat më të favorshme në lidhje me njohjen e kualifikimeve të dhëna nga njëra nga Palët. Këto mund të përmbahen në një traktat ekzistues ose të ardhshëm, ose në një si rezultat, dhe pjesë e së cilës mund të bëhet një Palë e kësaj Konvente.

### Seksioni III. Parimet bazë për vlerësimin e kualifikimeve

#### Neni III.1

1. Titullarët e kualifikimeve të dhëna nga njëra nga Palët kanë një hyrje të përshtatshme në vlerësimin e këtyre kualifikimeve, me anë të një kërkesë të tyre adresuar një organizmi kompetent.

2. Në këtë pikë nuk bëhet asnjë dallim i bazuar në seksin, racën, ngjyrën e lëkurës, handikapin, gjuhën, opinione politike ose çdo opinion tjetër, origjinën kombëtare, etnike ose sociale, përkatësinë në një minoritet kombëtar, pasurinë, lindjen ose çdo rrethanë tjetër të kërkuarve, ose çdo rrethanë tjetër që nuk ka lidhje me vlerën e kualifikimit për të cilën është kërkuar njohja. Për të siguruar këtë të drejtë, çdo Palë angazhohet të ndërmarrë dispozitat e nevojshme për të vlerësuar çdo kërkesë njohjeje të kualifikimit, duke marrë parasysh vetëm njohjet dhe aftësitë e fituara.

#### Neni III.2

Çdo Palë do të kujdeset që procedurat dhe kriteret e përdorura për vlerësimin dhe njohjen të jenë transparente, koherente dhe të besueshme.

#### Neni III.3

1. Vendimet e njohjes merren mbi bazën e informacioneve të përshtatshme në lidhje me kualifikimet për të cilat është kërkuar njohja.

2. Përgjegjësia e dhënies së informacioneve të nevojshme bie, në radhë të parë, mbi kërkuarësin, i cili duhet t'i japë në mirëbesim.

3. Megjithë përgjegjësinë e kërkuarësit, me kërkesën e këtij të fundit, institucionet që kanë dhënë kualifikimet në fjalë kanë për detyrë t'i japin informacionet e përshtatshme në limitet kohore të arsyeshme. E njëjta detyrë bie edhe mbi institucionet ose organet kompetente të vendit ku është kërkuar njohja.

4. Palët u japin udhëzime të gjitha institucioneve të arsimit, sipas sistemeve të tyre arsimore, të përcjellin çdo kërkesë të arsyeshme informacione të bërë me qëllim vlerësimin e kualifikimeve të bëra në këto institucione ose, sipas rasti, t'i inkurajojnë këto institucione për ta bërë këtë gjë.

5. U takon organizmave që ndërmarrin vlerësimin të vërtetojnë se një kërkesë nuk i plotëson kushtet e nevojshme.



#### Neni III.4

Me qëllim lehtësimin e njohjes së kualifikimeve, çdo Palë do të kujdeset që të jepen informacione të nevojshme dhe të qarta mbi sistemin e vet arsimor.

#### Neni III.5

Vendimet e njohjes merren me një afat të arsyeshëm, të përcaktuar paraprakisht nga autoritetet kompetente në çështjet e njohjes, duke filluar nga momenti kur janë dhënë të gjitha informacionet e duhura për ekzaminimin e kërkesës. Në rast të një vendimi negativ, jepen arsytet e refuzimit dhe kërkuesi informohet mbi masat që mund të marrë për të arritur njohjen në një moment të dytë. Në rast të një vendimi negativ ose të mungesës së vendimit, kërkuesi duhet të ketë mundësinë të apelojë kundrejt këtij vendimi në një afat kohor të arsyeshëm.

Seksioni IV. Njohje e kualifikimeve që lejojnë hyrjen në arsimin e lartë

#### Neni IV.1

Çdo Palë njihet (me qëllim hyrjen në programet që varen nga sistemi i tij i arsimit të lartë), kualifikimet e dhëna nga Palët e tjera dhe që plotësojnë, në këto Palë, kushtet e përgjithshme të hyrjes në arsimin e lartë, vetëm më rastet kur mund të vërtetohet se ekziston një ndryshim thelbësor ndërmjet kushteve të përgjithshme të hyrjes në Palën në të cilën është bërë kualifikimi dhe në Palën ku është kërkuar njohja.

#### Neni IV.2

Në mënyrë aletrnative, mjafton që njëra Palë t'i lejojë titullarit të një kualifikimi të kryer në njërin nga Palët e tjera të arrijë vlerësimin e këtij kualifikimi, me kërkesën e titullarit të kualifikimit, dhe dispozitat e nenit IV zbatohen mutatis mutandis në një rast të tillë.

#### Neni IV.3

Kur kualifikimi lejon hyrjen vetëm në disa tipe institucionesh ose programesh specifike të arsimit të lartë në Palën në të cilën është kryer ky kualifikim, çdo Palë tjetër i garanton titullarit të një kualifikimi të tillë hyrjen në disa programe specifike të ngjashme në institucionet që varen nga sistemi i tij i arsimit të lartë, me përjashtim të rastit kur vërtetohet se ekziston një ndryshim thelbësor ndërmjet kushteve të hyrjes në Palën në të cilën është kryer kualifikimi dhe kushtet e hyrjes në Palën në të cilën kërkohet njohja e kualifikimit.

#### Neni IV.4

Kur pranimi në programet e veçanta të arsimit të lartë varet nga kushte të veçanta plotësuese të kushteve të përgjithshme të hyrjes, autoritetet kompetente të Palës përkatëse mund t'i imponojnë të njëjta, kushte plotësuese titullarëve të kualifikimeve të kryera në Palët e tjera ose të vlerësojnë nëse kërkuesit që kanë kryer kualifikime në Palët e tjera plotësojnë të njëjtat kushte.

#### Neni IV.5

Kur në Palën tjetër, në të cilën janë marrë dëftesat e arsimit të mesëm, lejojnë hyrjen në arsimin e lartë vetëm kur shoqërohen nga dëshmi të dhënies së provimeve plotësuese, si kusht paraprak për hyrjen, Palët e tjera mund të kushtëzojnë hyrjen me të njëjtat kërkesa ose të ofrojnë një alternativë që mund të plotësojë këto kërkesa plotësuese në gjirin e sistemeve të tyre arsimore. Çdo Shtet, Selia e Shenjtë, Komuniteti European, në momentin e nënshkrimit ose në momentin e

depozitimit të instrumentit të ratifikimit, të pranimit, aprovimit ose aderimit, ose në çdo moment tjetër në vazhdim, mund t'i deklarojnë njërit prej depozituesve se përdorin dispozitat e këtij neni, duke precizuar Palët kundrejt të cilëve ato kanë ndërmend të zbatojnë këtë nen, si dhe arsyet që justifikojnë këtë masë.

#### Neni IV.6

Pa paragjykuar dispozitat e neneve IV.1, IV.2, IV.3, IV.4 dhe IV.5, pranimi në një institucion të përcaktuar të arsimit të lartë ose në një program të caktuar të këtij institucioni mund të jetë i kufizuar ose selektiv. Në rastet kur pranimi në një institucion dhe/ose në një program të arsimit të lartë është selektiv, procedurat e pranimit duhet të jenë të konceptuara në atë mënyrë që vlerësimi i kualifikimeve të huaja bëhet konform me principet e barazisë dhe të mosdiskriminimit të përshkruar në seksionin III.

#### Neni IV.7

Pa paragjykuar dispozitat e neneve IV.1, IV.2, IV.3, IV.4 dhe IV.5, pranimi në një institucion të caktuar të arsimit të lartë mund të varet nga prova që disponon kërkuesi. Kjo provë mund të jetë e njohjes së mjaftushme të gjuhës ose të gjuhëve të mësimin në institucionin në fjalë ose gjuhë të tjera të specifikuar.

#### Neni IV.8

Në Palët në të cilat hyrja në arsimin e lartë mund të arrihet mbi bazën e kualifikimeve jotradicionale, kualifikime të tjera të ngjashme të kryera në Palë të tjera vlerësohen në të njëjtën mënyrë si kualifikimet jo tradicionale të kryera në Palën në të cilën kërkohet njohja.

#### Neni IV.9

Për arritur pranimin në programet e arsimit të lartë, çdo Palë mund të pranojë që njohja e kualifikimeve të kryera nga një institucion arsimor i huaj, i vendosur në territorin e vet, i nënshtrohet kushteve specifike të legjislacionit kombëtar ose marrëveshjeve specifike të nënshkruara me Palën prej nga është origjina e këtij institucioni.

### Seksioni V. Njohja e periudhave të studimit

#### Neni V.1

Secila Palë njeh periudhat e studimeve të kryera në kuadër të një programi të arsimit të lartë në një Palë tjetër. Kjo njohje përfshin periudhat e studimeve që synojnë përfundimin e një programi të arsimit të lartë në Palën në të cilën është kërkuar njohja, me përjashtim të rasteve kur mund të vërtetohet se ekziston një ndryshim thelbësor ndërmjet periudhës së studimeve të kryera në një Palë tjetër dhe pjesës së programit të arsimit të lartë që ato do të zëvendësonin në Palën ku është kryer njohja.

#### Neni V.2

Në një alternativë tjetër, mjafton që një Palë t'i lejojë një personi që ka kryer një periudhë studimesh në kuadër të një programi të arsimit të lartë të një Pale tjetër të marrë një vlerësim të kësaj periudhe studimesh, me kërkesë të vetë personit, dhe dispozitat e nenit V.1, në një rast të tillë, zbatohen mutatis mutandis.

### Neni V.3

Në veçanti, secila Palë lehtëson njohjen e periudhave të studimit kur:

- a) ka një marrëveshje paraprake ndërmjet, nga njëra anë, institucionit të arsimit të lartë ose autoritetit kompetent përgjegjës për periudhën e studimeve dhe nga ana tjetër, institucionit të arsimit të lartë ose autoritetit kompetent në çështje të njohjes, përgjegjës për njohjen e kërkuar; dhe
- b) institucioni i arsimit të lartë ku është kryer periudha e studimeve dhe është lëshuar një certifikatë ose listë notash që vërteton se studenti i ka plotësuar kërkesat e nevojshme për këtë periudhë studimesh.

### Seksioni VI. Njohja e kualifikimeve të arsimit të lartë

#### Neni VI.1

Në rastet kur një vendim njohjeje bazohet mbi njohjet dhe dijet e vërtetuara nga një kualifikim i arsimit të lartë, secila Palë njuh kualifikimet e arsimit të lartë të dhëna nga një Palë tjetër, me përjashtim të rasteve kur mund të vërtetohet se ekziston një ndryshim thelbësor ndërmjet kualifikimit të cilit i kërkohet njohja dhe kualifikimit korrespondent në Palën në të cilën kërkohet njohja.

#### Neni VI.2

Në mënyrë alternative, mjafton që një Palë t'i lejojë mbajtësit të një kualifikimi të arsimit të lartë, të dhënë nga njëra nga Palët e tjera, të marrë një vlerësim të këtij kualifikimi, me kërkesë të mbajtësit, dhe në këtë rast dispozitat e nenit VI.1 zbatohen mutatis mutandis.

#### Neni VI.3

Njohja nga njëra Palë e një kualifikimi të arsimit të lartë i dhënë nga një Palë tjetër mbart dy pasojat e mëposhtme ose njërën prej tyre:

- a) hyrjen në studimet e larta plotësuese, duke përfshirë provimet që kanë të bëjnë me to, dhe/ose në përgatitjen e doktoratës, në të njëjtat kushte me ato që zbatohen për mbajtësit e kualifikimeve të Palës në të cilën është kërkuar njohja.
- b) përdorimin e një titulli akademik sipas ligjeve, rregullave ose të juridiksionit të Palës në të cilën është kërkuar njohja.

Përveç kësaj, njohja mund të lehtësojë hyrjen në tregun e punës, sipas ligjeve, rregullave ose juridiksionit të Palës në të cilën është kërkuar njohja.

#### Neni VI.4

Vlerësimi, nga një Palë, i një kualifikimi të arsimit të lartë të dhënë nga një Palë tjetër mund të ketë njërën nga format e mëposhtme:

- a) vlerësime të papërdorshme për qëllime pune;
- b) vlerësime të drejtuara një institucioni arsimor për pranim në programet e tij;
- c) vlerësime të destinuara për çdo autoritet tjetër kompetent në çështje njohjesh.

#### Neni VI.5

Duke qenë se flitet për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë të dhëna nga një institucion i arsimit të lartë i vendosur në territorin e vet, secila Palë mund t'ia nënshtrijë këtë njohje kushteve specifike të legjislacionit kombëtar ose marrëveshjeve specifike të nënshkruara me Palën prej nga e cila varet ky institucion.

Seksioni VII. Njohje e kualifikimeve të refugjatëve, e personave të zhvendosur dhe e personave të krahasuar me refugjatët.

#### Neni VII

Secila Palë merr të gjitha masat e mundshme dhe të arsyeshme në kuadrin e sistemit të vet arsimor, konform dispozitave konstitucionale, ligjore dhe administrative, për të përpunuar procedurat e përshtatshme që lejojnë vlerësimin e drejtë dhe efikas, nëse refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat e ngjashëm me refugjatët plotësojnë kushtet e nevojshme për hyrjen në arsim të lartë, ndjekjen e programeve të arsimit të lartë plotësuese ose ushtrimin e një aktiviteti profesional dhe kjo do të ndodhë edhe kur kualifikimet e kryera në njërin nga Palët nuk mund të vërtetohen nga dokumente që mund ta bëjnë këtë gjë.

Seksioni VIII. Informacion mbi vlerësimin e institucioneve dhe programeve të arsimit të lartë.

#### Neni VIII.1

Secila Palë jep informacionet e nevojshme mbi të çdo institucion që varet nga sistemi i saj i arsimit të lartë, si dhe mbi çdo program të organizuar nga këto institucione, me qëllim që t'u krijojë mundësinë autoriteteve kompetente të Palëve të tjera të verifikojnë nëse cilësia e kualifikimeve të dhëna nga këto institucione justifikon njohjen në Palën në të cilën është kërkuar njohja. Një informacion i tillë paraqitet si më poshtë:

a) në rastin e Palëve që kanë krijuar një sistem zyrtar të vlerësimit të institucioneve dhe të programeve të arsimit të lartë; informacion mbi metodat dhe rezultatet e këtij vlerësimi dhe mbi normat e cilësisë specifike për çdo tip institucioni të arsimit të lartë që jep kualifikime të arsimit të lartë dhe programet e tyre;

b) në rastet e Palëve që nuk kanë krijuar një sistem zyrtar të vlerësimit të institucioneve dhe të programeve të arsimit të lartë; informacion mbi njohjen e kualifikimeve të ndryshme të kryera në çdo institucion ose nëpërmjet çdo programi që varet nga sistemi i tyre i arsimit të lartë.

#### Neni VIII.2

Secila Palë merr dispozitat e nevojshme për të përcaktuar, rifreskuar dhe për të shpërndarë:

a) një tipologji të tipeve të ndryshme të institucioneve të arsimit të lartë, që varen nga sistemi përkatës i arsimit të lartë, duke përfshirë karakteristikat specifike për çdo tip institucioni;

b) një listë të institucioneve (publike dhe private) të njohura si vartëse të sistemit arsimor përkatës, duke saktësuar kapacitetin e tyre për të dhënë tipe të ndryshme kualifikimesh, si dhe kushtet e kërkuara për hyrjen në çdo tip institucioni dhe programi;

c) një përshkrim i programeve të arsimit të lartë;

d) një listë institucionesh të arsimit, të ndodhura jashtë territorit të saj dhe që ajo konsideron si vartëse të sistemit të saj arsimor.

Seksioni IX. Informacion mbi çështjet e njohjes

#### Neni IX.1

Për të lehtësuar njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë, Palët angazhohen të përcaktojnë sisteme transparente që lejojnë një përshkrim të plotë të kualifikimeve të dhëna.

#### Neni IX.2

1. Duke ditur domosdoshmërinë e informacioneve të duhura, të sakta dhe të rifreskuara,

secila Palë krijon ose mirëmban një qendër kombëtare të informacionit dhe i njofton njërit prej depozituesve këtë krijim ose çdo modifikim që ka të bëjë me të.

2. Në secilën Palë, Qendra Kombëtare e Informacionit:

a) lehtëson marrjen e informacioneve të sakta dhe të besueshme mbi sistemin e arsimit të lartë dhe kualifikimet e vendit në të cilin ndodhet;

b) lehtëson marrjen e informacioneve mbi sistemet e arsimit të lartë dhe kualifikimit të Palëve të tjera;

c) jep këshilla ose informacione mbi njohjet dhe vlerësimet e kualifikimeve, duke respektuar ligjet dhe rregullat kombëtare.

3. Çdo qendër kombëtare informacioni duhet të ketë në dispozicion mjetet e nevojshme për të kryer funksionet e saj.

### Neni IX.3

Palët inkurajojnë, me ndërmjetësinë e qendrave kombëtare të informacionit ose me mjete të tjera, përdorimin, nga institucione të arsimit të lartë të palëve, të Suplementit të Diplomës të UNESCO-s, Këshillit të Evropës ose çdo dokument tjetër i krahasueshëm.

Seksioni X. Mekanizmat e zbatimit

### Neni X.1

Organet e mëposhtme vëzhgojnë, nxisin dhe lehtësojnë zbatimin e Konventës:

a) Komiteti i Konventës mbi njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në rajonin e Europës;

b) Rrjeti European i Qendrave Kombëtare të Informacionit mbi njohjen dhe mobilitetin akademik (rrjeti ENIC i krijuar me vendim të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës më 9 qershor 1994 dhe të Komitetit Rajonal për Europën i UNESCO-s më 18 qershor 1994).

### Neni X.2

1. Komiteti i Konventës mbi njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në rajonin europian (që nga ku moment “Komiteti”) krijohet nga kjo Konventë. Ai është i përbërë nga një përfaqësues për çdo Palë.

2. Për nenin X.2, termi “Palë” nuk aplikohet për Komunitetin European.

3. Shtetet e përmendura në nenin XI.1.1 dhe Selia e Shenjtë, nëse nuk janë Palë në këtë Konventë, Komuniteti European si dhe Presidenti i rrjetit të ENIC mund të marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit si vëzhgues. Përfaqësues të organizatave qeveritare dhe joqeveritare që veprojnë në fushën e njohjes në Rajon mund të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Komitetit si vëzhgues.

4. Edhe Presidenti i Komitetit Rajonal të UNESCO-s për zbatimin e Konventës mbi njohjen e studimeve dhe diplomave të arsimit të lartë në Shtetet që i përkasin Rajonit të Europës do të ftohet të marrë pjesë në mbledhjet e Komitetit si vëzhgues.

5. Komiteti nxit zbatimin e kësaj Konvente dhe vëzhgon vënien e saj në jetë. Për këtë qëllim, ai mund të miratojë, me shumicën e Palëve rekomandime, deklarata, protokolle dhe kode praktike për të ndihmuar autoritetet kompetente të Palëve në zbatimin e Konventës dhe në shqyrtimin e kërkesave të njohjes së kualifikimeve të arsimit të lartë. Megjithëse nuk detyrohen nga këto tekste, Palët nuk do të kursejnë asnjë përpjekje për t'i zbatuar, për t'i vënë në vëmendje të autoriteteve kompetente dhe për të inkurajuar zbatimin e tyre. Komiteti kërkon mendimin e Rrjetit ENIC para se të marrë vendimet e tij.

6. Komiteti u raporton instancave përkatëse të Këshillit të Europës dhe UNESCO-s.

7. Komiteti siguron lidhjen me komitetet rajonale të UNESCO-s për zbatimin e konventave mbi njohjen e studimeve, diplomave dhe gradave të arsimit të lartë, të miratuara nën patronazhin e UNESCO-s.

8. Kuorumi arrihet kur është e pranishme shumica e Palëve.

9. Komiteti miraton rregulloren e tij të brendshme. Ai mbledhet në një sesion të zakonshëm të paktën çdo tre vjet. Komiteti mbledhet për herë të parë brenda afatit njëvjeçar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

10. Sekretariati i Komiteteit i besohet bashkërisht Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës dhe Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s.

### Neni X.3

1. Secila Palë zgjedh si anëtare të Rrjetit Europian të Qendrave Kombëtare të Arsimit mbi mobilitetin dhe njohjen akademike (Rrjeti ENIC, Qendra Kombëtare e Informacionit e krijuar ose mirëmbajtur nga Pala sipas nenit IX.2), në rastin kur janë krijuar më shumë se një qendër kombëtare e informacionit në një Palë sipas nenit IX.2; të gjitha këto qendra janë anëtare të Rrjetit, por këto qendra kombëtare të informacionit disponojnë vetëm një zë.

2. Rrjeti ENIC, në përbërjen e tij që kufizohet në qendrat kombëtare të informacionit të Palëve në këtë Konventë, sjell mbështetjen e tij dhe ndihmën në zbatimin praktik të Konventës nga autoritetet kombëtare kompetente. Rrjeti mbledhet të paktën një herë në vit në sesion plenar. Ai zgjedh Presidentin dhe Byronë e tij në përputhje me mandatin e tij.

3. Sekretariati i Rrjetit ENIC i besohet bashkërisht Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës dhe Drejtorit të Përgjithshëm të UNESCO-s.

4. Palët bashkëpunojnë, nëpërmjet Rrjetit ENIC, me qendra të tjera të informacionit të Palëve të tjera, duke u bërë të mundur marrjen e çdo informacioni të nevojshëm për realizimin e aktiviteteve të qendrave kombëtare të informacionit në lidhje me njohjen dhe mobilitetin akademik.

## Seksioni XI. Dispozita finale

### Neni XI.1

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim:

a) ndaj Shteteve anëtare të Këshillit të Europës;

b) ndaj Shteteve anëtare të Rajonit të Europës të UNESCO-s;

c) ndaj çdo nënshkruesi tjetër, Shtet kontraktues ose Palë e Konventës kulturore europiane të Këshillit të Europës dhe/ose të Konventës së UNESCO-s mbi njohjen e studimeve dhe diplomave të arsimit të lartë në Shtetet e Rajonit të Europës, që janë të ftuar të marrin pjesë në Konferencën diplomatike e ngarkuar për miratimin e kësaj Konvente.

2. Këto Shtete dhe Selia e Shenjtë mund ta shprehin miratimin e tyre për të qenë të lidhur:

a) me nënshkrim, pa rezerva ratifikimi, pranimi ose aprovimi, ose

b) me nënshkrim, duke iu nënshtruar ratifikimit, pranimi ose aprovimit, pasuar nga ratifikimi, pranimi se aprovimi; ose

c) me aderim.

3. Nënshkrimet do të bëhen pranë një depozituesi. Instrumentet e ratifikimit, pranimi, aprovimit ose aderimit do të depozitohen pranë njërit prej depozituesve.

### Neni XI.2

Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit, që vjen pas skadimit të një afati njëmuor pas shprehjes së miratimit të pesë Shteteve, prej të cilëve të paktën tre Shtete anëtare të Këshillit të Europës dhe/ose të Rajonit Europë të UNESCO-s, për të qenë të lidhur nga kjo Konventë. Ajo do të hyjë në fuqi, për çdo shtet tjetër, ditën e parë të muajit që vjen pas skadimit të afatit njëmuor pas datës së shprehjes së miratimit për të qenë e lidhur nga kjo Konventë.

### Neni XI.3

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, çdo Shtet përveç atyre që i përkasin njëres prej kategorive të renditura në nenin XI.1 mund të paraqesë një kërkesë aderimi në Konventë. Çdo kërkesë do t'i komunikohet njërit prej depozituesve, i cili do t'ua transmetojë Palëve të paktën tre muaj para mbledhjes së Komitetit të Konventës mbi njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Rajonin European. Depozituesi do të njoftojë edhe Komitetin e Ministrave të Këshillit të Europës dhe të Këshillit Ekzekutiv të UNESCO-s.

2. Vendimi për të ftuar një Shtet që ka paraqitur kërkesë për të aderuar në këtë Konventë merret me më shumë se dy të tretave të Palëve.

3. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komuniteti Evropian mund të aderojë, me kërkesën e Shteteve të tij anëtare, kërkesë që i drejtohet njërit prej depozituesve. Në këto rrethana, neni XI.3.2 nuk zbatohet.

4. Për çdo Shtet aderues, dhe për Komitetin European, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që vjen pas skadimit të afatit njëmuajor pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit pranë njërit prej depozituesve.

### Neni XI.4

1. Palët e kësaj Konvente, që janë në të njëjtën kohë Palë të njëres ose disa prej Konventave të mëposhtme:

Konventa Europiane mbi ekuivalentimin e diplomave që lejojnë hyrjen në institucionet universitare (1953, STE No 15) dhe Protokollin e saj (1964, STE No 49);

Konventa Europiane për ekuivalentimin e periudhave të studimeve universitare (1956, STE No 21);

Konventa Europiane mbi njohjen akademike të kualifikimeve universitare (1959, STE No 32);

Konventa Ndërkombëtare mbi njohjen e studimeve, të diplomave dhe të gradave të arsimit të lartë në Shtetet Arabe dhe në Shtetet Europiane që larg Mesdheu (1976);

Konventa mbi njohjen e studimeve dhe të diplomave të arsimit të lartë në Shtetet e Rajonit të Europës (1979);

Konventa Europiane mbi ekuivalentimin e përgjithshëm të periudhës së studimeve universitare (1990, STE 138):

a) do të zbatojnë dispozitat e kësaj Konvente në marrëdhëniet e tyre reciproke;

b) do të vazhdojnë të zbatojnë konventat e përmendura më sipër, në të cilat ato janë Palë, në marrëdhëniet e tyre me Shtetet të tjera Palë në konventat e mësipërme, por jo në këtë Konventë.

2. Palët e kësaj Konvente angazhohen të abstenojnë nga të qenit Palë në konventat e përmendura në paragrafin 1, në të cilat ato nuk do të ishin ende Palë, me përjashtim të Konventës Ndërkombëtare mbi njohjen e studimeve, të diplomave dhe gradave të arsimit të lartë në Shtetet Arabe dhe Shtetet Europiane që lagen nga deti Mesdhe.

### Neni XI.5

1. Çdo Shtet mund të përcaktojë territorin ose territoret për të cilët zbatohet kjo Konventë në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit në Konventë.

2. Në çdo moment tjetër, secili Shtet mund ta shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër me një deklaratë të drejtuar njërit prej depozituesve. Konventa do të hyjë në fuqi, për këtë territor, ditën e parë të muajit që vjen pas skadimit të një afati njëmuajor, duke filluar nga data e marrjes së një deklaratë të tillë nga depozituesit.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve të mësipërm, për çdo territor të përcaktuar nga një deklaratë e tillë, mund të tërhiqet me një notë drejtuar njërit prej depozituesve. Ajo do të ketë efekt ditën e parë të muajit që vjen pas skadimit të një afati njëmuajor pas datës së marrjes së një note të tillë nga depozituesit.

## Neni XI.6

1. Secila Palë mund të denoncojë në çdo moment këtë Konventë me një notë drejtuar njërit prej depozituesve.

2. Denoncimi do të ketë efekt ditën e parë të muajit që vjen pas skadimit të një afati prej dymbëdhjetë muajsh pas datës së marrjes së notës nga depozituesi. Megjithatë, ky denoncim nuk do të prekë vendimet e njohjes të marrë më parë sipas dispozitave të kësaj Konvente.

3. Anulimi i kësaj Konvente ose pezullimi i zbatimit të saj si rrjedhojë e shkeljes nga ana e një Pale të një dispozite thelbësore për realizimin e objektivit ose qëllimit të Konventës do të bëhet konform ligjeve ndërkombëtare.

## Neni XI.7

1. Çdo Shtet, Selia e Shenjtë, Komuniteti European mund të deklarojë se rezervojnë të drejtën për të mos zbatuar, pjesërisht totalisht, njërin ose disa prej neneve të mëposhtëm të kësaj Konvente. Kjo rezervë mund të bëhet në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të ratifikimit pranimit aprovimit ose aderimit në Konventë. Nenet nën rezervë:

Neni IV.8

Neni V.3

Neni VI.3

Neni VIII.2

Neni IX.3

Asnjë rezervë tjetër nuk mund të bëhet.

2. Çdo Palë që ka formuluar një rezervë sipas paragrafit të mësipërm mund ta tërheqë, të gjithën ose pjesërisht, me një notë drejtuar njërit prej depozituesve. Tërheqja merr efekt datën e marrjes së notës nga depozituesit.

3. Një Palë që ka formuluar një rezervë kundrejt një dispozite të kësaj Konvente nuk mund të pretendojë zbatimin e saj nga një Palë tjetër; megjithatë, ajo mund të pretendojë zbatimin e kësaj dispozite në masën që ajo ka pranuar në rastin kur rezerva është e pjesshme ose e kushtëzuar.

## Neni XI.8

1. Komiteti i Konventës mbi njohjen e kualifikimeve në arsimin e lartë në Rajonin European mund të miratojë projekte amendamentesh për këtë Konventë me një vendim të marrë me më shumë se dy të tretat e Palëve. Çdo amendament i miratuar në këtë mënyrë është i përfshirë në një protokoll të kësaj Konvente. Protokolli specifikon modalitetet e hyrjes së tij në fuqi e cila, për çdo rast, kërkon miratimin e Palëve në mënyrë që ato të lidhen me protokollin.

2. Asnjë amendament nuk mund të bëhet për seksionin III të kësaj Konvente sipas procedurës së paragrafit 1 më sipër.

3. Çdo propozim amendamenti duhet t'i komunikohet njërit prej depozituesve, i cili do t'ua transmetojë Palëve të paktën tre muaj para mbledhjes së Komitetit. Depozituesi do të informojë edhe Komitetin e Ministrave të Këshillit të Europës dhe Këshillin Ekzekutiv të UNESCO-s.

## Neni XI.9

1. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës dhe Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën janë depozituesit e kësaj Konvente.

2. Depozituesi pranë të cilit është depozituar një akt, notë ose komunikatë do t'u bëjë të ditur Palëve këtë Konventë, si dhe Shteteve të tjera anëtare të Këshillit të Evropës dhe/ose Rajonit Europë të UNESCO-s:

1. çdo nënshkrim;

2. depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit;

3. çdo datë hyrjeje në fuqi të kësaj Konvente sipas dispozitave të neneve XI.2 dhe XI.3.4;



4. çdo rezervë të bërë për zbatimin e dispozitave të nenit XI.7 dhe tërheqjen e çdo rezerve të bërë për zbatimin e dispozitave të nenit XI.7;
  5. çdo denoncim të kësaj Konvente në zbatim të nenit XI.6;
  6. çdo deklaratë të bërë sipas dispozitave të nenit II.1 ose nenit II.2;
  7. çdo deklaratë të bërë sipas dispozitave të nenit IV.5;
  8. çdo kërkesë aderimi të bërë sipas nenit XI.3;
  9. çdo propozim të bërë sipas nenit XI.8;
  10. çdo akt tjetër, notë ose komunikim që ka të bëjë me këtë Konventë.
3. Depozituesi që merr një komunikatë ose procedon sipas një note sipas dispozitave të kësaj Konvente do të informojë menjëherë depozituesit e tjerë.

Në mirëbesim, përfaqësuesit e nënshkruar, të autorizuar plotësisht, kanë firmosur këtë Konventë.

Bërë në Lisbonë, më 11 prill 1997, në gjuhët angleze, frënge, ruse dhe spanjolle, të katër tekstet duke patur vlerë të barabartë, në dy kopje, njëra prej të cilave do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës dhe tjetra në arkivat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën dhe një kopje e noterizuar do t'u shpërndahet të gjitha Shteteve të përmendura në nenin XI.I, Selisë së Shenjtë dhe Komunitetit Europian, si dhe Sekretariatit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

**L I G J**  
**Nr.8835, datë 22.11.2001**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “PROTOKOLLIN PËR SHTYPJEN E VEPRIMEVE TË PALIGJSHME NË AEROPORTET, QË I SHËRBEJNË AVIACIONIT CIVIL NDËRKOMBËTAR”, SHITESË E “KONVENTËS PËR SHTYPJEN E VEPRIMEVE TË PALIGJSHME KUNDËR SIGURISË SË AVIACIONIT CIVIL”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Protokollin për shtypjen e veprimeve të paligjshme në aeroportet që i shërbejnë aviacionit civil ndërkombëtar” të 24 shkurtit 1988, shtesë e “Konventës për shtypjen e veprimeve të paligjshme kundër sigurisë së aviacionit civil”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3170, datë 10.12.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**

## PROTOKOLL

Për shtypjen e veprimeve të paligjshme në aeroportet që i shërbejnë aviacionit civil ndërkombëtar, shtesë e Konventës për shtypjen e veprimeve të paligjshme kundër Sigurisë së Aviacionit Civil, hartuar në Montreal më 23 shtator 1971

Shtetet Palë në këtë Protokoll,

Duke parë se veprimet e paligjshme të dhunës, të cilat rrezikojnë ose mund të rrezikojnë sigurinë e njerëzve në aeroportet që i shërbejnë aviacionit civil ndërkombëtar ose të cilat vënë në rrezik funksionimin e sigurtë të aeroporteve të tillë, dobësojnë besimin e popujve të botës në sigurinë e aeroporteve të tilla dhe shqetësojnë sigurinë dhe drejtimin e rregullt të aviacionit civil për të gjitha Shtetet;

Duke parë se ndodhja e veprimeve të tilla është një çështje me shqetësim të madh për komunitetin ndërkombëtar dhe se, me qëllim që të pengohen veprime të tilla, ekziston nevoja urgjente për marrjen e masave të duhura për ndëshkimin e shkelësve të ligjit;

Duke parë se është e nevojshme të miratohen klauzola shtesë ndaj atyre të Konventës për shtypjen e Akteve të Paligjshme për Sigurinë e Aviacionit Civil, të hartuar në Montreal më 23 shtator 1971, për t'u marrë me veprime të tilla të paligjshme të dhunës në aeroport që i shërbejnë aviacionit civil;

Kanë rënë dakort si më poshtë:

### Neni 1

Ky Protokoll plotëson Konventën për shtypjen e Veprimeve të Paligjshme për Sigurinë e Aviacionit Civil, të hartuar në Montreal më 23 shtator 1971 (dhe këtu të referuar si "Konventa"), dhe se midis Palëve të këtij Protokolli, Konventa dhe Protokolli duhet të lexohen së bashku si një instrument i vetëm.

### Neni 2

1. Në nenin 1 të Konventës do të shtohet si një paragraf i ri 1 bis sa më poshtë:

"1 bis. Çdo person kryen një shkelje në qoftë se në mënyrë të paligjshme dhe qëllimisht, duke përdorur çfarëdo pajisje, substancë ose armë:

a) kryen një akt dhune ndaj një personi në një aeroport që i shërben aviacionit civil ndërkombëtar që shkakton ose mund t'i shkaktojë dëmtime serioze ose vdekje; ose

b) shkatërron ose dëmton rëndë lehtësirat e një aeroporti që i shërbejnë aviacionit civil ndërkombëtar ose një avioni jo në shërbim i vendosur atje ose ndërpret shërbimet e aeroportit, nëse një akt i tillë rrezikon ose mund të rrezikojë sigurinë në atë aeroport.

2. Në paragrafin 2(a) të nenit 1 të Konventës fjalët e mëposhtme duhet të shtohen pas fjalëve "paragrafi 1".

"ose paragrafi 1 bis"

### Neni 3

Në nenin 5 të Konventës, teksti i mëposhtëm do të shtohet si paragrafi 2 bis:

"2 bis. Çdo Shtet Kontraktues duhet gjithashtu të marrë masat e nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi shkeljet e përmendura në nenin 1, paragrafi 1 bis dhe në nenin 1 paragrafi 2, në masën që ai paragraf lidhet me ato shkelje, në rastin ku shkelësi i pretenduar është i pranishëm në territorin e tij dhe ai nuk e ekstradon atë, në përputhje me nenin 8 në Shtetin e përmendur në paragrafin 1 (a) të këtij neni".

### Neni 4

Ky Protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim në Montreal më 24 shkurt 1988 nga Shtetet pjesëmarrëse në Konferencën Ndërkombëtare për Ligjin e Ajrit të mbajtur në Montreal nga 9 deri

më 24 shkurt 1988. Pas 1 marsit 1988, Protokollin do të jetë i hapur për nënshkrim për të gjitha Shtetet në Londër, Moskë, Uashington dhe Montreal, deri sa ai të hyjë në fuqi në përputhje me nenin VI.

#### Neni 5

1. Ky Protokoll do t'i nënshtrohet ratifikimit nga Shtetet nënshkruese.
2. Çdo Shtet që nuk është Shtet Kontraktues i Konventës mund ta ratifikojë këtë Protokoll, në qoftë se në të njëjtën kohë ai ratifikon ose miraton Konventën në përputhje me nenin 15 të saj.
3. Instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Qeverisë së Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike, Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, Shteteve të Bashkuara të Amerikës ose Organizatës të Aviacionit Civil Ndërkombëtar, të cilët me anë të këtij dokumenti janë caktuar si vendet depozituese.

#### Neni 6

1. Menjëherë sapo dhjetë nga Shtetet Kontraktuese të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit të këtij Protokollin, ai do të hyjë në fuqi midis tyre në ditën e tridhjetë pas datës të depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit. Ai do të hyjë në fuqi për çdo Shtet që depoziton instrumentet e tij të ratifikimit pas asaj date, në ditën e tridhjetë pas depozitimit të instrumenteve të tij të ratifikimit.

2. Menjëherë sapo ky Protokoll të hyjë në fuqi, ai do të regjistrohet nga Depozituesit sipas nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe sipas nenit 83 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, (Çikago, 1944).

#### Neni 7

1. Ky Protokoll, pasi të ketë hyrë në fuqi, do të jetë i hapur për aderim, nga çdo Shtet jo nënshkrues.

2. Çdo Shtet që nuk është Shtet Kontraktues i Konventës mund të aderojë në këtë Protokoll në qoftë se në të njëjtën kohë që ai ratifikon ose aderon në Konventë sipas nenit 15 të saj.

3. Instrumentet e aderimit do të depozitohen pranë Depozituesve dhe aderimi do të fitojë efekt në ditën e tridhjetë pas depozitimit.

#### Neni 8

1. Çdo Palë në këtë Protokoll mund ta denoncojë atë me anë të njoftimit me shkrim drejtuar vendeve depozituese.

2. Denoncimi do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas datës në të cilën është marrë njoftimi nga vendi depozitues.

3. Vetë denoncimi i këtij Protokollin nuk duhet të ketë si efekt denoncimin e Konventës.

4. Denoncimi i Konventës nga një Shtet Kontraktues i Konventës, pasi është plotësuar nga ky Protokoll, do të ketë gjithashtu fuqinë e denoncimit të këtij Protokollin.

#### Neni 9

1. Depozituesit duhet të njoftojnë menjëherë të gjitha Shtetet nënshkrues dhe aderues në këtë Protokoll, si dhe të gjithë Shtetet nënshkruese dhe aderues në Konventë:

a) për datën e çdo nënshkrimi dhe datën e depozitimit të çdo instrumenti ratifikimi ose miratimi të këtij Protokollin, dhe

b) për datën e ndonjë njoftimi, denoncimi të këtij Protokollin dhe për datën e tij.

2. Depozituesit duhet të njoftojnë gjithashtu Shtetet e përmendur në paragrafin 1 për datën në të cilën ky Protokoll hyn në fuqi sipas nenit VI.

Në dëshmi të kësaj, të Plotfuqishmit e poshtëshënuar, duke qenë të autorizuar në mënyrën e duhur nga Qeveritë e tyre, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Bërë në Montreal më njëzet e katër shkurt, njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë, në katër origjinale, secili i hartuar në katër tekste autentike në gjuhët anglisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht.

## 52/164 KONVENTA NDËRKOMBËTARE PËR NDALIMIN E BOMBARDIMEVE TERRORISTE

### Asambleja e Përgjithshme

Duke kujtuar rezolutën e saj të datës 4 dhjetor 1994, me anë të së cilës ajo miratoi Deklaratën mbi masat për të eliminuar Terrorizmin Ndërkombëtar dhe Rezolutën e saj 51/210 të datës 17 dhjetor 1996;

Pasi kanë marrë parasysh tekstin e projektkonventës për ndalimin e bombardimeve terroriste të përgatitur nga Komiteti Ad Hoc i krijuar me anë të rezolutës së Asamblesë të Përgjithshme 52/210 të datës 17 dhjetor 1996 dhe grupi i punës i Komitetit të Gjashtë:

1. Miraton Konventën Ndërkombëtare të Bombardimeve Terroriste, aneksuar rezolutës së tanishme dhe vendos të hapë atë për nënshkrim në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork nga 12 janari 1998 deri më 31 dhjetor 1999.

2. Nxiti të gjitha Shtetet të nënshkruajnë dhe ratifikojnë, pranojnë ose miratojnë ose aderojnë në Konventë.

Mbledhja Plenare e 72-të, 15 dhjetor 1997.

### ANEKS (SHTOJCË)

#### **Konventa ndërkombëtare për ndalimin e bombardimeve terroriste**

Shtetet Palë në këtë Konventë,

Duke patur në mendje qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, lidhur me ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare dhe nxitjen e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe ato miqësore, si dhe bashkëpunimin midis Shteteve;

Thellësisht të shqetësuar për rritjen e konsiderueshme të akteve të terrorizmit në të gjitha format dhe shfaqjet e tij;

Duke kujtuar Deklaratën me Rastin e Përvjetorit të Pesëdhjetë të Kombeve të Bashkuara të 24 dhjetorit 1955;

Duke kujtuar gjithashtu Deklaratën mbi masat për të eliminuar Terrorizmin Ndërkombëtar, aneksuar Rezolutës të Asamblesë së Përgjithshme 49/60 të datës 9 dhjetor 1994, në të cilën, midis të tjerave, "Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara solemnisht riafirmojnë dënimin e qartë të të gjitha akteve, metodave dhe praktikave dhe terrorizmit si kriminale dhe të pajustificueshme, të kryera kudo dhe nga kushdo, duke përfshirë ato të cilat vënë në rrezik marrëdhëniet miqësore midis shteteve e popujve dhe që kërcënojnë integritetin territorial dhe sigurinë e Shteteve;

Duke parë se Deklarata i nxit gjithashtu Shtetet të rishikojnë menjëherë fushën e veprimit të dispozitave ligjore ndërkombëtare ekzistuese mbi parandalimin, ndalimin dhe eliminimin e terrorizmit në të gjitha format dhe shfaqjet e tij, me qëllim që të sigurojnë se ekziston një kuadër ligjor i përgjithshëm që mbulon të gjitha aspektet e çështjes;

Duke kujtuar Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 51/210 të datës 17 dhjetor 1996 dhe Deklaratën për të plotësuar Deklaratën mbi masat për eliminimin e terrorizmit ndërkombëtar të 1994 aneksuar asaj;

Duke parë se sulmet terroriste me anë të eksplozivëve ose të mjeteve të tjera janë përhapur gjithnjë e më shumë;

Duke vënë re, gjithashtu, se dispozitat ligjore shumëpalëshe ekzistuese nuk i drejtohen saktësisht këtyre sulmeve;

Duke qenë të bindur për nevojën urgjente të rritjes së bashkëpunimit ndërkombëtar midis Shteteve në hartimin dhe adoptimin e masave efikase dhe praktike për parandalimin e akteve të tilla të terrorizmit dhe për procedimin e dënimit e personave që i kryejnë ato.

Duke marrë parasysh se ndodhja e akteve të tilla është një çështje me shqetësim të madh për tërë komunitetin ndërkombëtar;

Duke parë se veprimet e forcave ushtarake të Shteteve drejtohen nga rregullat e së drejtës ndërkombëtare jashtë kuadrit të kësaj Konvente dhe se përjashtimi i disa veprimeve nga mbulimi i kësaj Konvente nuk i fal ose nuk i bën nga ana tjetër të ligjshme veprimet e paligjshme ose nuk përjashton procedimin sipas ligjeve të tjera.

Kanë rënë dakort si më poshtë:

## Neni 1

Për qëllimet e kësaj Konvente:

1. "Lehtësira e Shtetit ose Qeverisë" përfshin çdo lehtësi të përhershme ose të përkohshme ose mjet që përdoret ose zihet nga përfaqësuesi i një Shteti, anëtarët e qeverisë, pushtetit ligjvënës ose pushtetit gjyqësor ose nga zyrtarët ose punonjësit e një Shteti ose ndonjë autoriteti tjetër publik ose nga punonjësit ose zyrtarët e një organizate ndërqeveritare në lidhje me detyrat e tyre zyrtare.

2. "Lehtësira infrastrukturore" do të thotë çfarëdo lehtësire që zotërohet në mënyrë publike ose private që siguron ose përhap shërbimet për të mirën e publikut, si uji, sistemi i kanalizimit të ujrave të zeza, energjia karburanti ose komunikacionet.

3. "Eksplozivi ose pajisje (mjet) tjetër vdekjeprurëse do të thotë:

(a) një eksploziv ose armë zjarri ose pajisje që është projektuar ose ka aftësinë të shkaktojë vdekjen, dëmtime të rënda trupore ose dëmtime materiale të rëndësishme, ose

(b) një armë ose mekanizëm që është projektuar ose ka aftësinë për të shkaktuar vdekjen, dëmtime të rënda trupore ose dëmtime materiale të rëndësishme nëpërmjet çlirimit, përhapjes ose goditjes të lëndëve (kimikateve) helmuese, agjentëve biologjikë ose toksinave ose substancave të ngjashme me to ose rrezatimet ose materialit radioaktiv.

4. "Forcat ushtarake të një Shteti" do të thotë forcat e armatosura të një Shteti që janë të organizuara, të stërvitura dhe të pajisura sipas ligjit të brendshëm me qëllimin kryesor të mbrojtjes dhe sigurisë dhe personat që veprojnë në mbështetje të këtyre forcave të armatosura të cilët janë nën komandën, kontrollin e përgjegjësinë e tyre formale.

5. "Vend për përdorim publik" do të thotë ato pjesë të ndonjë ndërtese, toke, rruge, kanali lundrues ose vend tjetër i arritshëm ose i hapur për pjestarët e publikut, qoftë vazhdimisht, periodikisht ose rastësisht dhe rrethojnë çfarëdo vendi tregtar, biznesi, kulturor, historik, edukativ, fetar, argëtuës, dëfrimi ose vendi të ngjashëm që është i arritshëm dhe i hapur për publikun.

6. "Sistem transporti publik" do të thotë të gjitha lehtësirat, mjetet e transportit dhe mjetet qofshin publike ose private, që përdoren ose që janë për shërbime publike në dispozicion për transportin e personave ose ngarkesave.

## Neni 2

1. Çdo person kryen një shkelje brenda kuptimit të kësaj Konvente në qoftë se ai person në mënyrë të paligjshme dhe qëllimisht shpërndan, vendos ose plas një eksploziv ose pajisje (mjet) tjetër vdekjeprurës në, brenda ose kundër një vendi të përdorimit publik, një Shteti ose lehtësire qeveritare, një sistemi transporti publik ose një lehtësire infrastrukturore:

(a) me qëllim që të shkaktojë vdekje ose dëmtime të rënda trupore; ose

(b) me qëllim që të shkaktojë dëmtim të madh të një vendi, lehtësire ose sistemi të tillë, ku një shkatërim i tillë rezulton ose mund të rezultojë me humbje të mëdha ekonomike.

2. Çdo person kryen gjithashtu një shkelje në qoftë se ai person përpiket të kryejë një shkelje, siç përcaktohet në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Çdo person kryen gjithashtu një shkelje, në qoftëse ai person:

(a) merr pjesë si një bashkëpunëtor në shkelje, siç përcaktohet në paragrafin 1 ose 2 të këtij neni; ose

(b) organizon ose i drejton të tjerët të kryejnë një shkelje, siç përcaktohet në paragrafin 1 ose 2 të këtij neni ; ose

(c) në ndonjë mënyrë tjetër ndihmon në kryerjen e një ose shumë shkeljeve, siç përcaktohet në paragrafin 1 ose 2 të këtij neni, nga një grup personash që veprojnë me një qëllim të përbashkët një ndihmesë e tillë duhet të jetë e qëllimshme dhe/ose duhet të bëhet me synimin e çuarjes më tej të aktivitetit kriminal të përgjithshëm ose të synimeve të grupit ose duhet të bëhet duke ditur qëllimin e grupit për të kryer shkeljen ose shkeljet në fjalë.

### Neni 3

Kjo Konventë nuk do të zbatohet atje ku shkelja është kryer brenda një Shteti të vetëm, shkelësi i pretenduar dhe viktimat janë shtetas të atij Shteti, shkelësi i pretenduar gjendet në territorin e atij Shteti dhe asnjë Shtet tjetër nuk ka bazë në përputhje me nenin 6 paragrafi 1 ose 2 të kësaj Konvente për të ushtruar juridiksionin, përveç dispozitave të neneve 10 deri 15 që duhet të zbatohen si të përshtatshme në ato raste.

### Neni 4

Çdo Shtet Palë do të miratojë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme:

(a) për të përcaktuar si vepra penale sipas ligjit të tij të brendshëm shkeljet e përcaktuara në nenin 2 të kësaj Konvente.

(b) për të bërë ato shkelje të dënueshme me anë të dënimeve të përshtatshme që marrin parasysh natyrën e rëndë të atyre shkeljeve.

### Neni 5

Çdo Shtet Palë duhet të miratojë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme, duke përfshirë, atje ku është e përshtatshme, legjislacionin e brendshëm, për t'u siguruar që aktet kriminale brenda fushës së veprimit të kësaj Konvente, veçanërisht atje ku ato janë destinuar ose llogaritur për të provokuar një gjendje terrori në publikun e përgjithshëm ose në një grup personash ose persona të veçantë, në asnjë rrethanë nuk janë të justifikuara nga konsiderata të natyrës politike, filozofike, ideologjike, racionale, etnike, fetare ose të tjera të ngjashme me to dhe janë të dënueshme me dënimet që përputhen me natyrën e tyre të rëndë.

### Neni 6

1. Çdo Palë duhet të marrë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi shkeljet e përcaktuara në nenin 2 kur:

(a) shkelja është kryer në territorin e atij Shteti; ose

(b) shkelja kryhet në bordin e një anijeje që mban flamurin e atij Shteti ose një avioni që është i regjistruar sipas ligjeve të atij Shteti në kohën kur është kryer shkelja; ose

(c) shkelja kryhet nga një shtetas i atij Shteti.

2. Një Shtet Palë mundet gjithashtu të vendosë juridiksionin e tij mbi çfarëdo shkelje të tillë kur:

(a) shkelja kryhet kundër një shtetasi të atij shteti; ose

(b) shkelja kryhet kundër një lehtësire shtetërore ose qeveritare të atij Shteti jashtë, që përfshin një ambasadë ose mjedise diplomatike ose konsullore të atij Shteti; ose

(c) Shkelja kryhet nga një person pa shtetësi që e ka rezistencën e tij ose të saj të zakonshme në territorin e atij Shteti; ose

(d) shkelja kryhet në përprjekje për ta detyruar atë shtet të kryejë ose të abstenojë në kryerjen e ndonjë veprimi; ose

(e) shkelja kryhet në bordin e një avioni që drejtohet nga qeveria e atij Shteti.

3. Me ratifikimin, pranimin, miratimin ose aderimin në këtë Konventë, çdo Shtet Palë duhet të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për juridiksionin që ai ka vendosur sipas së drejtës së tij të brendshme në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni. Në qoftë se ndodh ndonjë ndryshim, Shteti Palë i interesuar duhet të njoftojë menjëherë Sekretarin e Përgjithshëm.

4. Çdo Shtet Palë duhet gjithashtu të marrë masa të tilla, që mund të jenë të nevojshme, për të vendosur juridiksionin e tij mbi shkeljet e përcaktuara në nenin 2 të rastet ku shkelësi i pretenduar është i pranishëm në territorin e tij dhe ai nuk e ekstradon atë person në ndonjë nga Shtetet Palë, të cilët kanë vendosur juridiksionin e tyre në përputhje me paragrafin 1 ose 2 të këtij neni.

5. Kjo Konventë nuk përjashton ushtrimin e ndonjë juridiksioni penal të vendosur nga një Shtet Palë, në përputhje me të drejtën e tij të brendshme.

#### Neni 7

1. Me marrjen e informacionit se një person, i cili ka kryer ose pretendohet të ketë kryer një shkelje siç përcaktohet në nenin 2 mund të jetë i pranishëm në territorin e tij, Shteti Palë i interesuar duhet të marrë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme sipas së drejtës së tij të brendshme për të hetuar faktet që përmbahen në informacion.

2. Pasi binden se rrethanat e përligjin një gjë të tillë, Shteti Palë në territorin e të cilit shkelësi ose shkelësi i pretenduar është i pranishëm duhet të marrë masat e duhura sipas së drejtës së tij të brendshme, me qëllim që të sigurojë praninë e atij personi për qëllimin e procedimit ose ekstradimit.

3. Çdo person ndaj të cilit po merren masat e parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, ka të drejtë:

(a) të komunikojë pa vonesë me përfaqësuesin e përshtatshëm më të afërt të Shtetit, shtetas i të cilit ai person është ose të shtetit, i cili është i detyruar të mbrojë të drejtat e tij në mënyrë tjetër ose në qoftë se ai person është një person pa shtetësi, Shteti në territorin e të cilit ai person banon zakonisht;

(b) të vizitohet nga një përfaqësues i atij Shteti;

(c) të informohet për të drejtat e atij personi sipas nënparagrafëve (a) dhe (b).

4. Të drejtat e përmendura në paragrafin e këtij neni duhet të ushtrohen në përputhje me ligjet dhe rregullat e Shtetit në territorin e të cilit shkelësi ose shkelësi i pretenduar është i pranishëm, sipas klauzolës që ligjet dhe rregullat në fjalë duhet të bëjnë të mundur dhënien e veprimit të plotë të qëllimeve që synojnë të drejtat që përshkruhen sipas paragrafit 3.

5. Dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni nuk do të paragjykojnë të drejtën e çdo Shteti Palë që ka (një) pretendim për juridiksionin në përputhje me nenin 6 nënparagrafi 1 (c) ose 2 (c) për të ftuar Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq që të komunikojë dhe vizitojë shkelësin e pretenduar.

6. Kur një Shtet Palë, sipas këtij neni ka mbajtur një person nën arrest, ai duhet të njoftojë, direkt ose nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Shtetet Palë që kanë vendosur juridiksionin sipas nenit 6 paragrafit 1 dhe 2 dhe në qoftë se ai e konsideron të këshillueshme, ndonjë nga Shtetet e tjera Palë të interesuara, për faktin që ky person është nën arrest dhe të rrethanave për të cilat justifikohet mbajtja e personit. Shteti, i cili bën hetimin e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni duhet të informojë menjëherë Shtetet Palë të përmendura për rezultatet e tij dhe duhet të tregojë se kur ka ndërmend të ushtrojë juridiksionin.

#### Neni 8

Shteti Palë, në territorin e të cilit shkelësi i pretenduar është i pranishëm duhet, në rastet për të cilat zbatohet neni 6 nëse nuk ekstradohet personi, të jetë i detyruar pa asnjë lloj përjashtimi dhe pavarësisht nëse shkelja kryhet në territorin e tij ose jo, t'i paraqesë rastin, pa vonesa të

pajustificuara autoriteteve të tij kompetente me qëllim hetimi, sipas procedurave në përputhje me ligjet e atij Shteti. Këto autoritete duhet të marrin vendimin e tyre në të njëjtën mënyrë si në rastin e ndonjë shkelje tjetër të natyrës së rëndë sipas ligjit të atij shteti.

2. Kurdoherë që një Shtet Palë, lejohet sipas së drejtës së tij të brendshme, të ekstradojë ose ndryshe, të dorëzojë një nga shtetasit e tij vetëm me kusht që personi do t'i kthehet atij shteti për të kryer dënimin e dhënë si rezultat i gjykimit ose procedurës për të cilën ekstradimi ose dorëzimi i personit është kërkuar dhe ky shtet dhe shteti që kërkon ekstradimin e personit bien dakort me këtë mundësi dhe kushtet e tjera që ata mund t'i gjykojnë të përshtashme, një ekstradim ose dorëzim i tillë i kushtëzuar do të jetë i mjaftueshëm për t'u çliruar nga detyrimet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

#### Neni 9

1. Shkeljet e përcaktuara në nenin 2 duhet të gjykojnë për t'u përfshirë si shkelje të ekstradueshme në ndonjë traktat ekstradimi që ekziston midis ndonjërit prej Shteteve Palë, para hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Shtetet Palë marrin përsipër të përfshijnë shkelje të tilla si shkelje të ekstradueshme në çdo traktat të ardhshëm ekstradimi që do të lidhet midis tyre.

2. Në qoftë se një Shtet Palë që e kushtëzon ekstradimin me ekzistencën e një marrëveshjeje, merr një kërkesë për ekstradim nga një Shtet tjetër Palë, me të cilin ai nuk ka marrëveshje ekstradimi në qoftë se ai vendos ta bëjë ekstradimin, mund ta konsiderojë këtë Konventë si bazë ligjore për ekstradimin në lidhje me shkeljet e përcaktuar në nenin 2.

Ekstradimi do t'i nënshtrohet dispozitave procedurale dhe kushteve të tjera ligjore të së drejtës së shtetit që i kërkohet.

3. Shtetet Palë, të cilët nuk e kushtëzojnë ekstradimin me ekzistencën e ndonjë marrëveshjeje, do t'i njohin këto shkelje si shkelje të ekstradueshme ndërmjet njëri-tjetrit, duke iu nënshtuar dispozitave procedurale dhe kushteve të tjera të së drejtës së shtetit që i kërkohet.

4. Secili nga krimet do të trajtohet, për qëllimin e ekstradimit ndërmjet Shteteve Palë, sikur të jetë kryer jo vetëm në vendin në të cilin ai ndodhi, por gjithashtu në territoret e shteteve, që u kërkohet të vendosin juridiksionin e tyre në përputhje me nenin 6, paragrafin 1 dhe 2.

5. Dispozitat e të gjitha traktateve të ekstradimit dhe rregullimet midis Shteteve Palë lidhur me shkeljet e përcaktuara në nenin 2 do të gjykojnë për t'u ndryshuar si midis Shteteve Palë, deri në shkallën që ato janë të papajtuësishëm në këtë Konventë.

#### Neni 10

1. Shtetet Palë duhet t'i japin njëri-tjetrit masën më të madhe të ndihmës në lidhje me hetimet ose procedurat penale ose të ekstradimit të filluara në lidhje me shkeljet e përcaktuara në nenin 2, duke përfshirë dhënien e të gjitha provave në dispozicion të tyre, të nevojshme për procedimin.

2. Shtetet Palë duhet të zbatojnë detyrimet sipas paragrafit 1 të këtij neni, në përputhje me çdo traktat ose rregullime të tjera mbi ndihmën ligjore të ndërsjellë (reciproke) që mund të ekzistojë midis tyre. Në mungesë të traktateve ose rregullimeve të tilla, Shtetet Palë duhet t'i sigurojnë njëri-tjetrit ndihmën në përputhje me të drejtën e tyre të brendshme.

#### Neni 11

Asnjë nga shkeljet e përcaktuara në nenin 2 nuk duhet të shihen, për qëllimet e ekstradimit ose të ndihmës ligjore të ndërsjellë si një shkelje politike ose si një shkelje e lidhur me një shkelje politike ose si një shkelje e frymëzuar nga qëllimet politike. Rrjedhimisht, një kërkesë për ekstradim ose për ndihmë ligjore të ndërsjellë të bazuar mbi një shkelje të tillë nuk mund të refuzohet me të vetmen arsye se ajo lidhet me një shkelje politike ose një shkelje të lidhur me një shkelje politike ose një shkelje të frymëzuar nga motive politike.



## Neni 12

Asgjë në këtë Konventë nuk duhet të interpretohet si vendosje e një detyrimi për të ekstraduar ose për të afruar ndihmën ligjore të ndërsjellë, në qoftë se Shteti Palë i kërkuar ka arsye konkrete (substanciale) për të besuar që kërkesa për ekstradim për shkeljet e përcaktuara në nenin 2 ose për ndihmë ligjore të ndërsjellë në lidhje me shkelje të tilla është bërë për qëllimin e procedimit ose dënimit të një personi për arsye të racës, fesë, shtetësisë, origjinës etnike ose bindjeve politike të atij personi ose se pajtimi me kërkesën do të mund të shkaktonte paragjykimin e pozicionit të atij personi për ndonjë nga këto arsye.

## Neni 13

1. Një person që mbahet i ndaluar ose vuan një dënim në territorin e një Shteti Palë, prania e të cilit në territorin e Shtetit tjetër Palë kërkohet për qëllimet e dëshmisë, identifikimit ose në dhënien e ndihmës për marrjen e të dhënave për hetimin ose gjykimin e shkeljeve sipas kësaj Konvente mund të transferohet nëqoftëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

(a) Personi jep lirisht pëlqimi e tij ose të saj me vënien në dijeni;

(b) autoritetet kompetente të dy Shteteve bien dakort sipas kushteve të tilla si ato që shtetet mund t'i gjykojnë të përshtatshme.

2. Për qëllimet e këtij neni:

(a) Shteti, në të cilin personi transferohet, duhet të ketë autoritetin dhe detyrimin për ta mbajtur personin e transferuar në arrest, në qoftë se ndryshe nuk kërkohet apo autorizohet nga shteti prej të cilit personi u transferua;

(b) Shteti në të cilin personi transferohet duhet të plotësojë pa vonesë detyrimin e tij për ta kthyer personin nën kujdestarinë e Shtetit nga i cili personi u transferua, siç është rënë dakort më parë ose siç bihet dakort ndryshe nga autoritetet kompetente të të dy shteteve;

(c) Shteti në të cilin personi transferohet nuk duhet t'i kërkojë Shtetit nga i cili ai u transferua të nisë procedurat e ekstradimit për kthimin e personit;

(d) Personit të transferuar duhet t'i njihet vuajtja e dënimit të kryer në shtetin prej të cilit u transferua për kohën e kaluar nën kujdesin e shtetit në të cilin ai u transferua.

(e) Deri sa Shteti Palë nga i cili një person do të transferohet në përputhje me këtë nen bie dakort, ai person, çfaridoqoftë shtetësia e tij ose e saj, nuk duhet të procedohet ose ndalohej ose t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë personale të tij ose të saj në territorin e shtetit në të cilin ai person transferohet lidhur me veprimet dhe bindjet para nisjes së tij ose të saj nga territori i Shtetit prej të cilit personi i tillë u transferua.

## Neni 14

Çdo person që mbahet nën arrest ose lidhur me të cilin merret ndonjë masë tjetër ose procesi gjyqësor kryhet sipas kësaj Konvente duhet t'i garantohet trajtimi i drejtë, që përfshin gëzimin e të gjitha të drejtave garancive, në përputhje me ligjin e Shtetit në territorin e të cilit ai person është i pranishëm dhe klauzolat e zbatueshme të ligjit ndërkombëtar, që përfshin ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

## Neni 15

Shtetet Palë duhet të bashkëpunojnë në parandalimin e shkeljeve të përcaktuara në nenin 2, veçanërisht:

(a) me anë të marrjes të të gjitha masave të zbatueshme, duke përfshirë, në qoftë se është e nevojshme, përshtatjen e legjislacionit të tyre të brendshëm, për të parandaluar dhe kundërshtuar përgatitjet në territoret e tyre përkatës për kryerjen e këtyre shkeljeve brenda ose jashtë territoreve të tyre, duke përfshirë masat për të ndaluar në territoret e tyre aktivitetet e paligjshme të personave, grupeve dhe organizatave që inkurajojnë, nxisin, organizojnë, financojnë me dashje ose angazhohen në kryerjen e shkeljeve siç përcaktohet në nenin 2;

(b) me anë të shkëmbimit të informacionit të saktë dhe të verifikuar në përputhje me të drejtën e tyre të brendshme, dhe nëpërmjet koordinimit të masave administrative dhe masave të tjera të përshtatshme për të parandaluar kryerjen e shkeljeve siç përcaktohet në nenin 2;

(c) aty ku shihet e nevojshme, nëpërmjet kërkimit dhe zhvillimit në lidhje me metodat e zbulimit të eksplozivëve dhe substancave të tjera të dëmshme që mund të shkaktojnë vdekje ose dëmtime fizike, konsultimeve mbi zhvillimin e standardeve për shënimin e eksplozivëve me qëllim që të identifikohet origjina e tyre në hetimet pas shpërthimit, shkëmbimit të informacionit mbi masat parandaluese, bashkëpunimit dhe transferimin e teknologjisë, pajisjeve dhe materialeve që lidhen me to.

#### Neni 16

Shteti Palë, në të cilin ndiqet penalisht shkelësi i pretenduar duhet, në përputhje me të drejtën e tij të brendshme ose procedurat e aplikueshme, t'i njoftojë rezultatin përfundimtar të procesit Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili ua transmeton informacionin Shteteve të tjera Palë.

#### Neni 17

Shtetet Palë do të zbatojnë detyrimet e tyre sipas kësaj Konvente në një mënyrë që përputhjet me parimet e barazisë sovrane dhe integritetit territorial të Shteteve dhe me atë të mos ndërhyrjes në punët e brendshme të shteteve të tjera.

#### Neni 18

Asgjë në këtë Konventë nuk i jep të drejtë një Shteti Palë të ndërmarrë në territorin e një Shteti tjetër Palë ushtrimin e juridiksionit dhe zbatimin e funksioneve të cilat janë ekskluzivisht të rezervuara për autoritetet e atij Shteti tjetër Palë sipas të drejtës së tij të brendshme.

#### Neni 19

1. Asgjë në këtë Konventë nuk do të ndikojë në të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë të tjera të Shteteve dhe individëve sipas së drejtës ndërkombëtare, veçanërisht qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare.

2. Aktivitetet e forcave të armatosura gjatë një konflikti të armatosur dhe ato siç kuptohen këto terma sipas të drejtës ndërkombëtare humanitare, të cilat rregullohen nga kjo e drejtë, nuk rregullohen nga kjo Konventë, dhe aktivitetet e ndërmarrë nga forcat ushtarake të një Shteti në ushtrim të detyrave të tyre zyrtare, në masën që ato rregullohen nga rregulla të tjera të së drejtës ndërkombëtare, nuk rregullohen nga kjo Konventë.

#### Neni 20

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë Shteteve Palë lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, e cila nuk mund të zgjidhet ndërmjet bisedimeve brenda një kohe të arsyeshme duhet, që me kërkesën e njerës prej tyre, t'i paraqitet arbitrimit. Në qoftë se, brenda gjashtë muajve nga data e kërkesës për arbitrim, Palët nuk janë në gjendje të bien dakord për organizimin e arbitrimit, çdo njëra nga Palët mund t'ia referojë çështjen në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë me anë të aplikimit, në përputhje me Statutin e Gjykatës.

2. Çdo Shtet në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit ose miratimit të kësaj Konvente ose të aderimit në të mund të deklarojë se ai nuk e konsideron veten e tij të detyruar nga paragrafi 1 i këtij neni. Shtetet e tjera Palë nuk do të detyrohen nga paragrafi 1 në lidhje me çdo Shtet që ka bërë një rezervim të tillë.

3. Çdo Shtet që ka bërë një rezervim në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, në çdo

kohë, mund ta tërheqë atë rezervim me anë të njoftimit drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

#### Neni 21

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga të gjitha Shtetet, duke filluar nga 12 janar 1998 deri më 31 dhjetor 1999 në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork.

2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

3. Kjo Konventë do të jetë e hapur për aderim nga çdo Shtet. Instrumentet e aderimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

#### Neni 22

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të njëzetë e dytë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Për çdo Shtet që ratifikon, pranon miraton ose aderon në këtë Konventë pas depozitimit të instrumentit të njëzet e dytë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit. Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit nga një shtet i tillë të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

#### Neni 23

1. Çdo Shtet Palë mund ta denoncojë këtë Konventë me anë të njoftimit me shkrim, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi do të hyjë në fuqi një vit pas datës në të cilën është marrë njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

#### Neni 24

Origjinali i kësaj Konvente, nga i cili tekstet në arabisht, kinezçe, anglisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht janë njëlloj autentike, do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili do t'i dërgojë kopjet e certifikuara të saj të gjitha Shteteve.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, të autorizuar në mënyrën e duhur nga Qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Konventë, të hapur për nënshkrim në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, më 12 janar 1998.

**V E N D I M**  
**Nr.13, datë 22.11. 2001**

**PËR DISA PLOTËSIME NË PËRBËRJEN E KOMISIONEVE**  
**TË PËRHERSHME TË KUVENDIT**

Në mbështetje të neneve 24 dhe 88 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I :**

- I. Në përbërje të komisioneve të përhershme të Kuvendit:
- 1) Zoti Bahri Kollçaku caktohet anëtar i Komisionit të Përhershëm të Arsimit, Kulturës, Shkencës dhe Sportit.
  - 2) Zoti Et'hem Fezollari caktohet anëtar i Komisionit të Përhershëm të Rendit dhe SHISH-it.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:  
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 20.12.2001  
Doli nga shtypi më 21.12.2001

Tirazhi: 4230 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2001

Çmimi: 200 lekë